Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 2 (34). SHKURT 2009. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

"Risku" sh.p.k.
Market "Ken"
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

AKTUALITET
"Rruga e Arbërit" kalon në Dibër të Madhe
Nga: **REXHEP TORTE** - FAQE 3

OPINION
Përmbytja e Dibrës - tradhti ndaj kombit
Nga: **ALI HOXHA** - FAQE 4

KUJTESË
Të vërteta dhe mite për "Djemtë e Maqellarës"
Nga: **ABDURRAHIM ASHIKU** - FAQE 5,7

PORTRET
R.Gjini, tregimtar i fuqishëm dhe jetësor
Nga: **PERIKLI JORGONI** - FAQE 11

OPINION

Të mbytet Ali!

Nga: **BUJAR KAROSHI**

Prej shumë kohësh, miku im dhe i shumë lexuesve, Ali Hoxha, po përpiqet të ndërgjegjësojë dibranët për të mos ndërtuar hidrocentralin e Skavicës, pasi kjo do të ishte në dëm të banorëve që jetojnë atje, në dëm të historisë, kulturës e traditës. Në dëm të Dibrës, në dëm të Shqipërisë!

E kam mbështetur Aliun dhe do të vazhdoja ta mbështesja, por të enjten e fundit të shkurtit ndërrova mendje! Ndërrova mendje, Ali! Dibra nuk duhet shpëtuar Ali, Dibra duhet mbytur!

Jo nga ajo përmbytje që mendojmë unë e ti, por një lloj tjetër që nuk është parë e dëgjuar deri më sot, madje as libri yt i Kuranit nuk e ka shkruar, Ali!

Shumë kohë më parë, kur pashë se Peshkopia po shkatërrohej e degradohej, po dilte nga ajo që mbaja mend unë, nga qyteti i vogël i blireve dhe gjelbërimit, mendoja se qytetarët do të reagonin, do të kërkonin të ndalej prishja e qytetit! Mendova do të ndalnin një hap në bulevardin e blireve dhe do i thonin STOP masakrës, por nuk e bënë.

Kur nisën idetë për zhvillimin e Dibrës, Ali, kur shumë dibranë të mirë mendonin t'u çonin këtyre njerëzve rrugë, nga Dibra Ali vinin veç lajme të këqija! Mos shihni ëndrra, nuk bëhet rruga, - thoshin, Ali. Qeveria ka shumë halle e probleme të mëdha!

Kur në mes të Tiranës, Ali, dhjetëra minatorë ishin në një grevë urie, asnjeri nuk e ndali hapin në Peshkopi, përkundrazi...

Kur kërkove, Ali, të mblidhje njerëz të mbronin çështjen tënde, çështjen e Skavicës, shihja dibranë, Ali, që mërmërisnin e iknin vjedhurazi .... Të quanin të prapambetur!

Kur ti, Ali, mblidhje 20 veta në Peshkopi, qindra të tjerë bënin sehir, të shihnin me bisht të syrit dhe nënqeshnin... Dhe e di, Ali... kanë menduar: "Është çmendur Aliu!"

Kur para një viti e vranë, e dhunuan një fëmijë, një engjëll, Ali, mendova se do shkundej njerëzia apo qytetaria, si i thonë me këtë të renë Ali, por për fat të keq tëndin, timin e të të gjithë nënave e baballarëve të Dibrës e të gjithë Shqipërisë, nuk ndodhi asgjë.


Nuk ndaluan as një minutë! Në të vërtetë, Ali, mendoja se do mblidheshin aq shumë njerëz, sa ç'mblidheshin kur vinte kohë më parë Sali Berisha dhe Fatos Nano, por s'u mblodhën edhe aq sa mblodhe ti, Ali, kundër Skavicës!

Por, Ali, më e keqja ishte lajmi i së enjtes! Nuk thuhet me fjalë, Ali! Dhe s'kam besim, Ali, se qytetarët e Dibrës do të bëjnë diçka t'i japin fund këtij "kiameti".

Prandaj, Ali, Dibra të mbytet! Por, duhet bërë edhe një gjë: Të mblidhen dibranët që janë atje dhe të ftohen dhe këta që janë këtej, të lidhen nga këmbët dhe të varen brigjeve të Skavicës! Bashkë me ne të të dy.

BULQIZË - URA E VASHËS

Gati tenderi për segmentin tjetër të Rrugës së Arbërit




Është gati për tenderim segmenti plotësisht i ri i Rrugës së Arbërit nga Bulqiza te Ura e Vashës. Ky segment, 13 km e 180 metra i gjatë fillon në Vajkal të Bulqizës dhe përfundon mbi Urën e Vashës në Klos. Projekti teknik parashikon ndërtimin e një tuneli prej 847 metrash, i cili do të kushtojë 19 milionë euro. Vlera e ndërtimit të segmentit tjetër parashikohet të kushtojë rreth 31 milionë euro.

Lexoni në FAQEN 2

Rruga Arbërit nr. 34
e ditës

Rruga e Arbërit do t'i japë jetë qarkut të Dibrës, do t'i japë jetë Bulqizës, Peshkopisë, Dibrës së Madhe, Klosit e Burrelit, po aq sa do të sjellë një frymëmarrje dhe hapësirë komunikimi për banorët e kryeqytetit.

BULQIZË - URA E VASHËS
Gati tenderi për segmentin tjetër të Rrugës së Arbërit



Ne foto: Pame nga gjurma e re e Rrugës së Arbërit, sipas projektit teknik të segmentit Bulqizë - Ura e Vashës

Është gati për tenderim segmenti plotësisht i ri i Rrugës së Arbërit nga Bulqiza te Ura e Vashës. Ky segment, 13 km e 180 metra i gjatë fillon në Vajkal të Bulqizës dhe përfundon mbi Urën e Vashës në Klos.
Projekti teknik parashikon ndërtimin e një tuneli prej 847 metrash, i cili do të kushtojë 19 milionë euro.
Vlera e ndërtimit të segmentit tjetër parashikohet të kushtojë rreth 31 milionë euro.

Së shpejti nisin punimet e vërteta në atë që quhet "Rruga e Arbërit". Është gati për tenderim segmenti plotësisht i ri i Rrugës së Arbërit nga Bulqiza te Ura e Vashës. Ky segment, 13 km e 180 metra i gjatë fillon në Vajkal të Bulqizës dhe përfundon mbi Urën e Vashës në Klos.

Burime zyrtare bëjnë të ditur për gazetën "Rruga e Arbërit" se po punohet intensivisht për përgatitjen e procedurave dhe shumë shpejt do të shpallet tenderi për fillimin e punimeve.

Projekti teknik mbi këtë segment plotësisht të ri të Rrugës së Arbërit parashikon ndërtimin e një tuneli prej 847 metrash, i cili do të kushtojë 19 milionë euro. Vlera e ndërtimit të segmentit tjetër parashikohet të kushtojë rreth 31 milionë euro. Aktualisht, në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve po punohet mbi një oponencë mbi këtë segment, por paralelisht po punohet edhe me përgatijen e procedurave për tenderim.

Siç shikohet edhe në hartën shoqëruese, punuar nga studio "IfraTransProjekt L.t.d", ky segment do të jetë plotësisht i ri dhe duket që anashkalon plotësisht rrugën e vjetër. Në Vajkal rruga del nga aksi aktual dhe vazhdon në anën perëndimore të qytetit të vjetër të Bulqizës. Në kryqëzimin e shëtitores që lidh qytetin e ri dhe qytetin e vjetër të Bulqizës, parashikohet ndërtimi i një mbikalimi, i cili nuk do ta ndërpresë lëvizjen në aksin e Rrugës së Arbërit. Me një tunel në Qafën e Buallit 847 metra, ajo del në luginën e Planit të Bardhë, duke vazhduar deri te Ura e Vashës. Mbi Urën e Vashës parashikohet ndërtimi i një ure, por detajet teknike të saj janë në përgatitje e sipër, paralelisht me hartimin e projektit teknik për segmentin Ura e Vashës - Qafa e Murrizës.

Kjo hartë e botuar, kopja zyrtare e se cilës është në dokumentat e tenderit që do të shpallet së shpejti, tregon se Rruga e Arbërit ka marrë udhë... Dhe, shumë shpejt, do të bëhet realitet ëndrra e dibranëve për të pasur një rrugë, e cila për fat të mirë nuk është vetëm e tyre, por e gjithë shqiptarëve.

Kjo rrugë do ti japë jetë qarkut të Dibrës, do t'i japë jetë Bulqizës, Peshkopisë, Dibrës së Madhe, Klosit e Burrelit, po aq sa do të sjellë një frymëmarrje dhe hapësirë komunikimi për banorët e kryeqytetit.

Rruga e Arbërit tashmë ka nisur udhën e saj...

B.K.

Posta e Rruga Arbërit

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Viron Kona, Dukagjin Hata, Mehmet Hasani, Agron Tufa, Abdurahim Ashiku, Moisi Murra, Selman Mziu, Ymer Keta, Xhelal Roçi, Odise Plaku, Ali Koçeku, Kujtim Boriçi, etj., se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës. Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Bashkëpunuan në këtë numër:
Rexhep TORTE,
Shaban SINANI
Abdurrahim ASHIKU,
Ali HOXHA
Isa HALILAJ
Beqir SINA
Mahmud HYSA
Perikli JORGONI
Dejang NOVA
Bernard ZOTAJ
Bajram HYSENI
Selman MEZIU
Artan HOXHA

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Cilado qeveri, cilido ministër apo ekspert që do ta anashkalonte Dibrën e Madhe nga "Rruga e Arbërit", do të bënte gabimin më të madh dhe do të merrte mallkimin përvëlues të djegieve, vrasjeve dhe eksodit të dibranëve nga ofensivat e përgjakshme serbe

"RRUGA E ARBËRIT" *nuk mund ta anashkalojë* Dibrën e Madhe

Nga: Rexhep TORTE

Ditë më parë u ngrit shumë plu hur rreth trasesë rrugore nga ku do të kalojë "Rruga e Arbëit" në Maqedoni. Në Shqipëri kjo rrugë tashmë ka filluar të ndërtohet në segmentin rrugor Bulqizë-Ura e Çerenecit, që nënkupton arritjen e saj deri në kufirin Shqipëri-Maqedoni, përkatësisht afër fshatit Kojnarë në Dibër të Madhe. Ekspertët e kanë parashikuar edhe unazën e kalimit të saj nëpër Dibër të Madhe daljen e saj deri te Ura e Boshkut, që është pikë lidhëse e rrugës aktuale Dibër-Mavrovë-Shkup, ku vitin që shkoi pas gati gjysmë shekulli, u bë edhe zgjerimi i rrugës gjer në Zhirovnicë.

Gazeta "Fakti" është i vetmi medium në Maqedoni dhe Shqipëri, që dhjetë viteve të kaluara e ka rrahur dhe sensibilizuar më së shumti problemin e ndërtimit të "Rrugës së Arbërit", të kësaj arterie të rëndësishme që do t'i mundësonte kësaj zone verilindore zhvillim të hovshëm në të gjitha fushat.

Nisma për ndërtimin e Rrugës së Arbërit në vitin 1995 erdhi nga Shoqata për Zhvillim e Kulturë "Nisma Dibrane" nga Peshkopia, nismë e cila u mbështet me pas edhe nga shoqatat "Bashkësia Dibrane" dhe "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" në Tiranë dhe nga Shoqata Qytetare "Votra Dibrane" në Dibër të Madhe.

Viteve të kaluara këto shoqata për "Rrugën e Arbërit" organizuan takime në Peshkopi, Dibër të Madhe dhe në Tiranë, me pjesëmarrje të pushteteve vendore, ministrave, deputetëve, ekspertëve dhe biznesmenëve të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Konklusionet nga këto takime u janë adresuar kryeministrave, kryetarëve të dy shteteve dhe ambasadave të huaja në Tiranë dhe Shkup.

"RRUGA E ARBËRIT" NË SHQIPËRI

Deklaratat e kohëve të fundit të Sali Berishës, kryeministrit të Shqipërisë," se pas përfundimit të Rrugës së Kukësit për në Kosovë, radhën e ka ndërtimi i "Rrugës së Arbërit", fillimi vitin që shkoi i ndërtimit me një ritëm të lartë i segmentit rrugor Bulqizë-Ura e Çerenecit pjesë e "Rrugës së Arbërit" në Shqipëri, në kufi me Dibrën e Madhe dhe paralajmërimi i fillimit të ndërtimit brenda këtij viti i rrugës Ura e Çerenecit- Peshkopi, si edhe takimet intensive me Bankën Botërore dhe me Bankën Islamike për sigurimin e mbështetjes financiare për tërë trasenë e kësaj rruge Tiranë-Dibër e Madhe, kanë shtuar shpresat dhe kanë rritur optimizmin te popullata në Shqipëri se pas një sërë premtimesh boshe vite me radhë Rruga e Arbërit po bëhet realitet.

Të rikujtojmë se Sali Berisha, kryeministër i Shqipërisë, në mitingun parazgjedhor 2005, deklaroi se,"Do ta ndërtojmë "Rrugën e Arbërit që afron Dibrën me fqinjët ballkanikë,por edhe me Evropën."Rruga e Arbërit" është detyrë e jona ndaj jush për lumin e djersës që keni derdhur dhe për pasuritë e nëntokës që keni nxjerrë. Ju meritoni një rrugë pesë herë më të gjatë se "Rruga e Arbërit"",ishin fjalët e Berishës drejtuar elektoratit.

Fatos Nano në mitingun parazgjedhor 2005, nuk nguroi të sjell edhe disa eskavatorë se gjoja në këtë qytete do të fillojnë punimet e "Rrugës së Arbërit",duke thënë se,"për këtë rrugë tashmë janë akorduar 13 miliardë lekë,se kjo rrugë do të sjell mirëqenie dhe komunikim për tërë rajonin", e që pas humbjes së zgjedhjeve u ndërprenë edhe punimet.

Të njëjtin fat e pati kjo rrugë edhe kur vite më parë, Ismail Lleshi, kandidat për deputet i PS në këtë zonë, i premtoi elektoratit se punimet e kësaj rruge do të fillojnë dhe se tritoli i armatës shqiptare në vend që të asgjësohej sipas rekomandimeve të NATO-s, do të përdorej për hapjen e tuneleve. Megjithatë Ilir Meta me tu bërë kryeministër, nuk e lejoi të realizohet ky premtim,për çka në shenjw proteste Ismail Lleshi nuk u ul kurrë në karrigen e deputetit.

Tashmë të gjithë e dinë se ndërtimi i kësaj rruge është e vetmja mundësi që popullata e kësaj zone ekonomikisht e prapambetur të zhvillohet.

Kjo rrugë ka rëndësi të jashtëzakonshme ekonomike,kulturore dhe kombëtare dhe i shërben në mënyrë të drejtpërdrejtë integrimit ndërshqiptar dhe Paktit të Stabilitetit për një Ballkan demokratik.

Kjo rrugë ka ekzistuar që nga lashtësia, si rrugë karvanesh e njohur me emrin Rruga e Dibrës. "Rruga e Arbërit" ka qenë nga më të frekuentuarat që nga mesjeta e hershme. Kjo rrugë ka qenë degë e rëndësishme e "Rrugës Via Egnatia". Ka qenë ndër rrugët më të rrahura nga mesjeta e hershme e deri vonë nëpër të cilën lëviznin deri 300 kuaj në ditë dhe në funksion të saj vetëm në fshatin Gur i Bardhë kishte dhjetë hane, katër fshatra roje, si Tujani, Gur i Bardhë, Klosi dhe Bulqiza.

"RRUGA E ARBËRIT" NË MAQEDONI

Maqedonia lidhur me "Rrugën e Arbërit" ka ngecur shumë.

Deklaratat që ditë më parë qarkulluan se ,"në Maqedoni do të ndryshojë traseja e "Rrugës së Arbërit" dhe se gjoja kjo rrugë do ta anashkalojë Dibrën e Madhe, janë ose të gabuara ose të keqkuptuara.

E para, "Rruga e Arbërit" nuk mund të quhet asnjë rrugë që nuk do të kalojë nëpër Dibër të Madhe. E dyta, cilado qeveri, cilido ministër , apo ekspert që do ta anashkalonte Dibrën e Madhe nga "Rruga e Arbërit", do ta bënte gabimin më të madh dhe do të merrte mallkimin përvëlues të djegieve, vrasjeve dhe eksodit të dibranëve nga ofensivat e përgjakshme serbe që Dibrën e Madhe e bënë tri herë shkrumb e hi dhe të sistemit shkatërrues monist. E treta, Shqipëria projektin e "Rrugës së Arbërit" dhe segmenti rrugor i kësaj rruge Bulqizë-Çerenec që po ndërtohet arrin deri te kufiri afër Dibrës së Madhe. E katërta,askush nuk ka të drejtë as morale e as pushtetare që t'ua shtojë edhe më shumë zullumin Dibrës së Madhe dhe dibranëve.

Nga Dibra e Madhe drejt Shkupit, mund të vazhdojë zgjerimi i rrugës ekzistuese në Grykën e Radikës, mund të realizohet edhe varianti nga Mavrova nëpër fshatin Galiçnik, mund të ndërtohet edhe segmenti rrugor 35 kilometra që do ta lidh Dibrën e Madhe me Kërçovën dhe segmenti rrugor 40 kilometra nga fshati Strezimir deri në kufirin me Kosovën, duke e zgjeruar degëzimin dhe duke i dhënë frymëmarrje më të gjerë "Rrugës së Arbërit". Është për të përshëndetur angazhimi i qeverisë aktuale të Maqedonisë për fillimin sa më të shpejtë të kësaj rruge, por gjithmonë duke patur në mëndje Dibrën e Madhe.


" Rruga e Arbërit" që pritet të ndërtohet dhe që është riaktualizuar kohëve të fundit, sipas variantit në Shqipëri, distancën Dibër e Madhe - Tiranë do ta shkurtojë nga 183 në 74 kilometra.

Ndërtimi i kësaj rruge do ta ringjallte këtë zonë të izoluar, do ta zvogëlonte mërgimin e banorëve të gjithë Dibrës, Gostivarit, Tetovës e më gjerë, sepse këto zona nëpërmjet të kësaj rruge do të jenë më afër Tiranës, më afër Durrësit dhe më afër botës.

Cilado qeveri, cilido ministër apo ekspert që do ta anashkalonte Dibrën e Madhe nga "Rruga e Arbërit", do të bënte gabimin më të madh dhe do të merrte mallkimin përvëlues të djegieve, vrasjeve dhe eksodit të dibranëve nga ofensivat e përgjakshme serbe, që Dibrën e Madhe e bënë tri herë shkrumb e hi dhe të regjimit shkatërrues monist.



Foto:Argjend R. Kaba (dibra.org)



Kjo foto është fragment i një posteri të botuar me kontributin e anëtarëve të shoqatës "Nisma Dibrane", e cila jepte një informacion të përgjithshëm për gjurmën e kalimit dhe avantazhet e ndërtimit të Rrugës së Arbërit. Para botimit të saj, shumë veta besonin se Rruga e Arbërit ishte një iluzion, por tani koha i ka kapërcyer këto mentalitete.

Rruga Arbërit nr. 34

opinion

Një opinion nga Ali Hoxha mbi domosdoshmërinë e ndalimit të procedurave për dhënien me koncension të Hidrocentralit të Skavicës:
Ja arsye se pse nuk duhet të ndërtohet Skavica!.

Shitja, përmbytja dhe asgjësimi i Dibrës - tradhti ndaj kombit

Nga **ALI HOXHA***



Projekti për të ashtuquajturin HEC-i i Skavicës, i cili parashikon përmbytjen e Pellgut të Dibrës që nga Reçi deri në Gjoricë, ka qenë përdorur si pretekst nga regjimi monist për të mos bërë asnjë investim në rrethin e Dibrës, duke e lënë këtë, krahinën më të prapambetur të Shqipërisë, sa që edhe rruga nacionale Kukës-Peshkopi ka mbetur edhe sot, ashtu siç është bërë qysh në vitin 1946, d.m.th. pa asnjë metër asfalt, unikale në gjithë Shqipërinë.

Në qoftë se projekti për ndërtimin e HEC-it të Skavicës do të ishte zbatuar para vitit 1990, ai do të ishte bërë nga shteti shqiptar dhe për interesa kombëtare. Shteti shqiptar i asaj kohe, me kushtetutë quhej "Shteti i Diktaturës së Proletariatit", për pasojë populli shqiptar ishte zhveshur nga pronësia mbi tokën e vet, d.m.th. ne ishim kthyer në proletarë të vërtetë, prandaj askush nuk kishte asnjë mundësi për të kundërshtuar projekte të tilla në atë kohë. Por, edhe pse shtet i diktaturës, ai vetë hoqi dorë nga zbatimi i atij projekti asgjësues,jo se nuk kishte mundësi për ta bërë atë HEC, por konkludoi se në rast se do të zbatohej ai projekt, dëmi ekonomik dhe etnokulturor do të ishte shumë më i madh se sa fitimi, sepse:

1) Në aspektin ekonomik, Dibra është "Myzeqeja", hambari i zonës verilindore të Shqipërisë. Ky pellg i Dibrës ka mbajtur me bukë jo vetëm gjithë Dibrën, por edhe Lumën, Mirditën e Matin, bile dhe Tiranën. Por dëmi ekonomik, për ne, qëndron në plan të dytë në krahasim me dëmin që shkaktohet në aspektin gjeopolitik dhe etnokulturor.

2) Në aspektin gjeopolitik Dibra e Poshtme do të shpërbëhej sepse pjesa lindore e Dibrës do t'i bashkëngjitej pjesës tjetër që ka mbetur nën pushtimin serbosllav qysh prej vitit 1913, kurse pjesa tjetër e Dibrës, në anën perëndimore të Drinit të Zi, do të copëtohej dhe do t'u bashkëngjitej rretheve të Kukësit, të Mirditës dhe të Matit. Pra nuk do të kishte më Dibër

3) Në aspektin etnokulturor dëmi është i pallogaritshëm, sepse nga përmbytja e këtij territori, asgjësohet një qytetërim i tërë, një etni e tërë, do të zhdukej e gjithë Dibra me gjithë historinë e saj, gjithë ato gjurmë të qytetërimit të lashtë iliro-pellazge, si dhe Principata e Kastriotëve dhe terreni ku u zhvilluan 19 betejat fitimtare të Skënderbeut, kundër supërfuqisë më të madhe të botës në atë kohë, nga 24 beteja gjithsej që ai bëri kundër Perandorisë Osmane; po kështu do të zhdukeshin edhe të gjitha varret e mijëra dëshmorëve të rënë për mbrojtjen e atdheut nga pushtuesit e të gjitha kohërave, duke u përmbytur përgjithmonë nga uji i atij "deti" artificial.

Në këtë aspekt, nisur nga ky këndvështrim, do të theksojmë se, në qoftë se vëllezërit tanë të Dibrës së Madhe që u detyruan të shpërnguleshin nga invadimi i pushtuesve serbo-sllave në vitet 1913-1920 dhe u vendosën në Tiranë, ata, kurdo që të kthehen në Dibër të Madhe, tokat dhe pronat aty i kanë.

Edhe vëllezërit tanë çamë do të kthehen një ditë në trojet dhe pronat e veta në Çamëri, ashtu siç u kthyen vëllezërit tanë kosovarë në trojet e veta pas shpërnguljes masive të vitit 1999, të cilët pronat dhe shtëpitë e veta, edhe pse të djegura e të bombarduara nga agresioni serb, aty i gjetën ato dhe i bënë të reja, bile edhe më të mira nga ç'ishin më parë;

Edhe palestinezët, herët a vonë, do të kthehen një ditë në trojet e veta në Palestinë, rindërtojnë shtetin e vet, sepse tokën aty e kanë.

Ndërsa pas përmbytjes së Pellgut të Dibrës nga ai "cunam" njerëzor, nga uji i liqenit, më saktë, i detit të atij projekti ogurzi, e gjithë Dibra me historinë e saj do të zhdukeshin nën ujë njëherë e përgjithmonë, kurse ne, dibranët, do të ktheheshim në emigrantë dhe endacakë të përjetshëm si arixhinjtë në çadra, dhe të shpërndarë si beduinët e shkretëtirave arabe.

Pra, që të jemi realistë, shteti i diktaturës së proletariatit, i para viteve '90 u tregua më më i përmbajtur, kur e anuloi atë projekt asgjësues të Dibrës, në një kohë kur ne dibranët, si gjithë shqiptarët, nuk kishim asnjë mundësi ligjore për të kundërshtuar në atë kohë projekte të tilla, asgjësuese, bile nuk kishin asnjë mundësi ligjore për të mbrojtur as shtëpinë tonë dhe as vetveten, e jo më të mbronim tërë krahinën dhe historinë e saj.

Kurse tani, pas vitit 1990, me shembjen e shtetit të Diktaturës dhe vendosjen e sistemit të Demokracisë kemi hyrë në një epokë të re, jemi në kushte të tjera historike. Është tepër sinjifikativ fakti se Dibra nuk e ka njohur dhe nuk e ka zbatuar të ashtuquajturin, ligjin nr. 7501 për shpërndarjen e tokës për frymë, por secila familje dibrane ka shkuar vetëm në atë pëllëmbë tokë të trashëguar nga të parët e vet. As në rastet kur me ligjin shtetëror mund të përfitonte më shumë, dibrani nuk ka pranuar të marrë tokën e tjetrit.

Por tani, krahas së mirës, për ne dibranët, na ka ardhur edhe një e keqe e madhe. Rreziku për Dibrën është real. Duke filluar që nga pranvera e vitit 2005, por sidomos tani në vitin 2008-2009 në pragun e zgjedhjeve parlamentare për ndërrimin e pushteteve si atëherë, ka dalë në skenë përsëri projekti asgjësues për Dibrën, i ashtuquajturi HEC-i i Skavicës. Theksojmë se ky projekt nuk paraqitet as nga shteti shqiptar dhe as për interesa kombëtare. Ata projekte janë paraqitur nga 6 (gjashtë) kompani të huaja për interesat e veta tregtare, sigurisht edhe në bashkëpunim me qarqe të caktuara të brendshme.

Fakti që njoftimi i dhënë nga Ministria e Energjetikës për ndërtimin në zonën e Lezhës e një parku energjetik me erë, nga kompania italiane "Moncada", njoftim ky i botuar në gazetën "Shekulli" të datës 5 dhjetor 2008, f. 6, me titull: "Parku me erë, energjia elektrike vetëm për eksport", është një argument tjetër më shumë se edhe HEC-i i Skavicës nuk kërkohet të bëhet për nevojat kombëtare, por vetëm për interesa, tregtare të disa individëve apo qarqeve të caktuara të pushtetarëve qendror dhe atyre lokalë, pa përmendur këtu interesat e kompanive të huaja.

Në këtë aspekt, përmendim këtu edhe një fakt tjetër tepër domethënës për çështjen tonë se, edhe vëllezërit tanë vlonjatë, në protestat e tyre kundër ndërtimit të një parku për prodhimin e energjisë me anë të erës, kishin një parullë shumë kuptimplotë: "Mullinjtë në Shqipëri, kurse rryma në Itali". Pra është e qartë nga gjithkush se 6 (gjashtë) kompanitë e huaja private nuk garojnë për të fituar tenderin që të "lulëzojnë" Dibrën tonë e ta bëjnë atë një vend turistik, por ata garojnë për të grabitur Dibrën dhe pasuritë e saj. prandaj, vëllezër dibranë, jini vigjilentë dhe mos bini pre nga mashtrimet apo kërcënimet e kompanive të huaja dhe të bashkëpunëtorëve të tyre vendas, por ta dini mirë se askush nuk do t'jua shpërblejë pronën tuaj më shumë se "një euro" për m2, d.m.th. sa një paketë cigare!

Sot gjithçka është privatizuar. Edhe KESH-i shqiptar, së shpejti do të privatizohet, më saktë do të grabitet dhe askush nuk do t'ju përgjigjet juve. A nuk i keni ndjekur kornikat televizive ku herë pas here shfaqen disa nga banorët e fshatrave të Kukësit, të vendosur në barakat e përroit të Drojës, në Mamurras, të cilat vazhdojnë të kërkojnë dëmshpërblimin e tokave të mbytura nga liqeni i HEC-it të Fierzës, por askush nuk ua dëgjon zërin atyre?!

Prandaj e gjykojmë me vend t'ua kujtojmë atyre pushtetarëve lokalë që mund të jenë bërë mercenarë të kompanive të huaja vetëm për një drekë në një hotel me pesë yje, apo për një "zarf" që mund t'ua kenë futur në xhep sekserët e atyre kompanive, ua kujtojmë atyre se "Kushtetuta" e të parëve tanë, Kanuni i Dibrës, ka një "nen" të caktuar që ata mercenarë nuk mund të shesin jashtë fisit as tokën e vet pa marrë më parë miratimin nga gjithë anëtarët e fisit, e jo më të mund të shitkan tokën e të tjerëve, pra Dibrën tonë.

Ndërsa pushtetarëve qendrorë, u sugjerojmë që ta studiojnë dhe ta njohin më mirë historinë e Dibrës dhe karakterin e dibranëve. Me këtë rast, përsëris edhe këtu se në të gjitha krahinat e Shqipërisë etnike, që nga Nishi në Veri e deri në Artë e Prevezë në Jug, dhe që nga Adriatiku në Perëndim dhe deri në Manastir e Preshevë, në Lindje, nuk ka krahinë shqiptare që të mos ketë varre dëshmorësh dibranë, d.m.th. dibranët çdo pëllëmbë të tokës arbërore e kanë mbrojtur me gjakun dhe me jetën e tyre nga pushtuesit e huaj të të gjitha kohërave. Në kundërshtim me sa sipër, është tepër domethënës fakti se në gjithë territorin e Dibrës, në asnjë qoshe të saj, nuk gjendet asnjë varr dëshmori jodibranë, të asnjë periudhe të historisë, që të ketë ardhur nga ndonjë krahinë tjetër në mbrojtje të Dibrës nga pushtuesit e huaj të të gjitha kohërave. Nuk llogariten këtu ata partizanë që u vranë në korrik të vitit 1944 në Fushë-Alie dhe në Sinë të Dibrës, pasi ajo ishte një luftë civile, sepse në atë periudhë atje nuk kishte asnjë këmbë pushtuesi. Pra theksoj se Dibra është mbrojtur në çdo kohë vetëm me forcat e veta.

Në këtë aspekt, mendoj se nuk është jashtë temës së trajtesës sonë, që të përmend këtu edhe një fakt ordiner të ditëve tona, por tepër sinjifikativ lidhur me trajtesën tonë: theksojmë se ai adoleshenti i gjimnazit të Saukut të Tiranës, i cili para dy-tre vjetësh, vetëm për një ofezë që i thanë "malok" dhe për një goditje me grusht që mori nga një shoku klase, pa i dhënë asnjë shkak, ai të nesërmen ia nxori zorrët në diell agresorit, dhe e dërgoi në botën tjetër, ai djalë është dibran, nga Kishaveci i komunës së Kastriotit, Fation Zira, trojet e të cilit i përmbyt projekti për HEC-in e Skavicës. Prandaj u tërheqim vëmendjen atyre kompanive të huaja që tentojnë të përmbytin Pellgun e Dibrës, duke i kthyer banorët e asaj krahine në emigrantë dhe endacakë të përjetshëm, si arixhinjtë, pasojat do të jenë të paparashikuara, sepse dibranët janë tepër të ndjeshëm në këtë aspekt. Prandaj autorëve të atyre projekteve asgjësuese të Dibrës, d.m.th. si atyre që duan ta shesin, ashtu edhe atyre që duan ta grabisin Dibrën, ua kujtojmë se as dje dhe as sot, akoma nuk kanë lindur ata burra që të mund të grabisin e të shesin Dibrën, sepse Dibra i ka tashmë pronarët e vet të ligjshëm prej mijëra vjetësh nuk ka nevojë për pronarë të rinj. Dibra nuk ka dalë as në shitje dhe as në ankand.

Në këtë kontekst, theksojmë këtu se përveç himnit kombëtar "Rreth Flamurit të përbashkuar", Dibra ka edhe një himn specifik të vetin qysh prej vitit 1844, i njohur me emrin me emrin "Kanga e Hajredin Pashës", ku, ndër të tjera, thuhet:

"Hajredin Pasha, ku e ke ushtrinë
Të gjithë në Dibër m'i kanë gri
Jo ma pak, veç dymbëdhjetë mijë!
Hajredin Pasha mor kraje shanajk
Nuk asht Dibra Selanajk
Selanajk, nuk asht për lepe,
Si e lipe, Pashë, në Dibër e gjete!"

Të parët tanë dibranë e dinin se për të bërë një jetë më të mirë, mund të ishin bërë kolaboracionistë, duke bashkëpunuar me pushtuesit, ose të kishin mërguar në vende të huaja duke u asimuluar, por ata nuk bënë as njërën as tjetrën. Ata sakrifikuan duke e mbrojtur me gjakun dhe jetën e tyre këtë truall të Arbërisë dhe lirinë e tyre. Është fakt historik i njohur se "Nëntë Malet e Dibrës", që nga koha e Skënderbeut e më pas, kurrë nuk u janë nënshtruar pushtuesve të huaj. Edhe gjatë sundimit 500-vjeçar të Perandorisë Osmane, Nëntë Malet e Dibrës, të vetmit në gjithë Perandorinë, kanë gëzuar një autonomi specifike, duke u vetëqeverisur gjithnjë me Kanunin e Maleve të Dibrës, e thënë ndryshe me Kanunin e Skënderbeut, edhe pse e gjithë krahina pranoi fenë Islame. Prandaj neve, brezit të sotëm dhe brezave të ardhshëm na bije detyra që Dibrën tonë dhe historinë e saj ta mbrojmë me çdo kusht, me të gjitha mjetet e ligjshme nga çdo rrezik që mund t'i kanoset asaj, veçanërisht nga ky "Cunam" njerëzor i përmbytjes dhe i asgjësimit të saj, i ashtuquajtur HEC-i i Skavicës.

Kjo gjë, kundërshtimi i atyre projekteve të ashtuquajtura HEC-i i Skavicës, është një sprovë e rëndë për ne, brezin e sotëm, por edhe për brezat e ardhshëm, sepse neve dibranëve ky "cunam" do të na qëndrojë mbi kokë si "shpata e Demokleut" edhe në të ardhmen, sa herë që do të bëhen zgjedhje të reja parlamentare për ndërrim pushtetesh nga partitë politike, pasi pushtetarët do ta përdorin herë pas here si gur shahu atë projekt të HEC-it të Skavicës, veç të tjerash, edhe për fushatë elektorale.

Por ne nuk duhet të dekurajohemi, sepse për mbrojtjen e trojeve tona etnike të trashëguara prej mijëra vjetësh nga të parët tanë dhe për ruajtjen e etnisë dhe të qytetërimit tonë mijëravjeçarë, ne, dibranët, nuk jemi vetëm, por gëzojmë edhe përkrahjen e intelektualëve patriotë nga mbarë Shqipëria, sepse mbrojmë një të drejtë themelore, ekzistencën e identitetit tonë, dibranë. Sa për ilustrim, e gjykoj me vend t'ju citoj në ligjëratë të drejtë përgjigjen e ambientalistit të mirënjohur vlonjat, akademikut Xhemal Mato, që i ka dërguar gazetarit të mirënjohur dibran, atdhetarit Abdurrahim Ashikut, emigrant në Athinë, për shkrimin e tij të botuar, së pari, në gazetën "Ndryshe" nr. 780 datë 26 nëntor 2008, f. 14-15, me titull "Apo mbytet Dibra" dhe së dyti në gazetën "Rruga e Arbërit" të muajit nëntor 2008, f. 6-7, me titull: "Po mbytet Dibra, ku janë dibranët?":

"... E lexova shkrimin tuaj dhe problemi m'u duk shumë i rëndësishëm dhe kompleks. Unë vetë mësova shumë gjëra dhe kuptova që pak e njoh problematikën që do të sjellë ndërtimi i Skavicës. Mendoj se intelektualët e zonës së Dibrës duhet të kërkojnë vlerësimin mjedisor që është bërë për këtë projekt (është e drejta e tyre dhe detyrim ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Kulturës). Gjithashtu me ligj ata kanë të drejtë ta anylojnë, nëse nuk janë dakord dhe argumentojnë ato që ju përmendni me të drejtë. Kjo është rruga ligjore, por siç e dini edhe ju, ligjet shpërfillen në këtë drejtim në Shqipëri, kështu që ngel hapi i dytë, gjyq, i cili gjithashtu nuk fitohet kollaj dhe s'e merr përsipër ta bëjë një grup i pabashkuar, shpesh i pamotivuar në ndërgjegje. Së fundi është gjyqi publik, të cilin ju jeni duke e bërë, por këtu të gjithë ata që janë dakord me ju duhet ta bëjnë dhe unë tashmë rreshtohem pas jush".

Pra, vëllezër dibranë, të jemi vigjilentë tani sa është herët, të zbatojnë këshillat e vëllaut tonë vlonjate, akademiku Xhemal Mato dhe të mos biem pre e mashtrimeve, apo kërcënimeve, sepse, përndryshe, do ta pësojmë si "viçi i Gjonit, në Mustafe, i cili nuk iu përgjigj thirrjes së të zotit për të dalë nga pylli që të kthehej në vathë, më përpara se ta hante ujku, por ai pëlliti vetëm kur e hëngri ujku..." por atëherë ishte tepër vonë.

Në këtë kuadër nuk mund të lëmë pa theksuar këtu se nuk duhet marrë i shkëputur, pa lidhje me synimet për shitjen, përmbytjen dhe asgjësimin e Dibrës edhe fakti i asaj fushate shpifjesh ndaj historisë nga disa individë, apo qarqe të caktuara antishqiptare, të brendshme dhe të jashtme, për denigrimin e figurës së simbolit kombëtar shqiptar, Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, themeluesit të shtetit të parë kombëtar shqiptar,. Mendojmë kështu pasi pellgu që përmbytet nga i ashtuquajturi HEC i Skavicës përmbyt edhe pjesën më të madhe të truallit të Principatës së Kastriotëve e të Skënderbeut. Taktika dhe strategjia e kësaj fushatë është shumë e qartë dhe krejtësisht antishqiptare, pasi, siç thotë proverbi popullor, ata "me një gur vriten dy zogj": duke errësuar figurën e heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, rrënjët e të cilit janë në Dibër, ua bën më të lehtë punën atyre qarqeve të caktuara që janë të interesuara për të grabitur e përmbytur Dibrën nëpërmjet projektit të HEC-it të Skavicës dhe nga ana tjetër, pas asgjësimit të Dibrës, të Principatës së Kastriotëve, për rrjedhojë do të zhduket edhe vet historia e tyre, pra edhe historia e vet Skënderbeut.

Prandaj, në këtë aspekt, për analogji me deklaratën e shkrimtarit të madh shqiptar, Ismail Kadare të dhënë para pak kohësh në një intervistë televizive, kur ndër të tjera tha:

"Përbaltja e figurës së Skënderbeut është një turp kombëtar", unë do të shtoj se të gjitha përpjekjet dhe projektet për shitjen, përmbytjen dhe asgjësimin e Dibrës dhe të historisë së saj janë TRADHTI KOMBËTARE. Këtë mendim e argumentoj me faktin se energjia e prodhuar nga HEC-i i Skavicës është projektuar jo për nevojat kombëtare, por për eksport dhe së dyti, për faktin se aq energji që parashikohet të prodhojë HEC-i i Skavicës, Dibra i ka të gjitha resurset, që nga ujëvarat e saj mund të ndërtohen rreth 10 (dhjetë) HEC-e të vegjël, të cilët do të jepnin po aq energjia elektrike sa ç'parashikon HEC-i i Skavicës, pa u dëmtuar asnjë pëllëmbë tokë. Në këtë aspekt, tradhti kombëtare do të bënim edhe ata dibranë që do të braktisnin trojet e veta, "vetëm për një euro", pasi do të humbasin identitetin e vet. Prandaj edhe njëherë u themi Ndal të gjitha projekteve për përmbytjen dhe asgjësimin e Dibrës dhe të historisë së saj.

**Autori është iniciues dhe President Nderi i Shoqatës "Për mbrojtjen e pronave dhe të mjedisit të Pellgut të Drinit të Zi".*

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: "rrugaearberit@gmail.com". Tel. 00355 4 22 33 283.

OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

"Një kujtesë mbi tragjedinë dibrane të vitit 1996.
Si rrodhën ngjarjet dhe si po dël në publik e vërteta..."

TË VËRTETA DHE MITE PËR "DJEMTË E DIBRËS"

- *Fragmente nga libri në dorëshkrim: TRAGJEDI DIBRANE – '96*



Nga:
ABDURAHIM ASHIKU

TRONDITJE...!

Një ngjarje e rëndë ka tronditur këto ditë gjithë zonën e Maqellarës të rrethit të Dibrës. Tronditja vjen nga lajmi se, një djalë i Ziaudin Qokut nga Maqellara, i nisur një javë më parë ilegalisht për në Itali, është gjetur i mbytur në ujërat e Otrantos në bregun tjetër të Adriatikut.

Lajmi mbërriti në komisariatin e punëve të brendshme të rrethit të Dibrës prej homologut të tij të rrethit të Vlorës. Të nisur për të marrë kufomën në Vlorë, njerëzit e familjes së viktimës kanë marrë atje përgjigjen se kufoma nuk është kthyer ende nga Italia.

Por zisë që ka pllakosur familjen Qoku në pritje të viktimës, i shtohet edhe ankthi i 30 familjeve të tjera të zonës së Maqellarës. Kjo për arsyen sepse, së bashku me të riun Qoku, janë nisur në drejtim të Italisë edhe rreth tridhjetë persona të tjerë nga kjo zonë. Familjet e tyre janë lidhur me të afërm në Itali, por asnjëri prej tyre nuk ka konfirmuar mbërritjen e njerëzve të kërkuar, të nisur nga Shqipëria. Hipotezat se ata kanë qenë në të njëjtin skaf me Qokun e mbytur dhe për pasojë kanë pasur të njëjtin fat, i ka tronditur njerëzit...

Gazeta "Zëri i Popullit", 14 mars 1996

VLORË - MARS 1996 !

Në prokurorinë e Vlorës, kanë ardhur disa familjarë nga fshati Burim dhe krahina e Maqellarës, që shpresojnë se është gjetur ndonjë shenjë e të afërmve të tyre, mbytur në mars të 1996. Punonjësi i prokurorisë së Vlorës, Ramazan Ilnica, që ka hetuar tragjedinë dhe që më pas është pushuar, në zbatim të ligjit, u është drejtuar familjarëve fatkeqë që të bëjnë kërkesë për t i shpallur të vdekur, në mënyrë që tu hapet rruga nuseve për tu martuar, për të ndarë pasuri dhe ndihmuar fëmijët jetimë. Por kjo është refuzuar edhe për shkakun se shpresohet të jenë gjallë dhe një ditë do të kthehen. Vetëm në fshatin Burim janë rreth 10 familje që presin e shpresojnë dhe ngurrojnë t i drejtohen gjykatës për të marrë një vendim që të konsiderohen të vdekur. Ilnica shprehet për gazetën se pjesa dërrmuese e dibranëve kanë qenë të rinj, martuar rishtas, me 1-2 fëmijë dhe shpresa se një ditë do të kthehen, ka ngujuar nuset që nuk guxojnë të bëjnë asnjë veprim, as të ndahen dhe ca më tepër të krijojnë një familje të re...

HETIM !?

Do të duhej tragjedia e 9 janarit të këtij viti që, me kërkesë të komisionit parlamentar të Rendit e SHISH-it si dhe Ministrisë së Rendit, të rihetohej tragjedia e 9 marsit 1996, një nga ngjarjet më të mistershme. Një grup ekspertësh të SHISH-it dhe të policisë janë bashkuar për të gjetur të vërtetën e ngjarjes. Fillimisht u skeduan tre sekserët që tashmë janë në kërkim, por që kanë humbur gjurmët. Emrat e tyre janë publikuar edhe më parë, por hetuesit shtatë vjet me radhë nuk kishin arritur t'i gjenin dot pronarët e skafit. Vetëm një nga trupat e klandestinëve u gjet në brigjet e Italisë, i lidhur në një dërrasë të vjetër. Nga hetimet, si dhe nga ekspertiza mjeko-ligjore rezultoi se vdekja e viktimës kishte ardhur për shkak të infarktit, pasi ai vuante nga zemra dhe nuk rezultoi të ishte i mbytur. Por me mister këtë fakt e veshi pala italiane, kur mjeku ligjor i Brindisit shënoi vetëm fjalën "vdekje", pa ia shtuar shkakun. Megjithatë vetë italianët kanë vënë në dispozicion të palës shqiptare vetëm një pjesë të dokumentacionit. Secili nga klandestinët ka paguar 1 mijë dollarë mesatarisht për të arritur tokën e ëndërruar. Po kështu nga investigimi i bërë në qytetin e Vlorës është gjetur se vetëm një nga të humburit ka qenë nga ky qytet, pikërisht Astrit Veseli, që mbeti i vdekur gjatë udhëtimit në Otranto. Ndërkohë është zbuluar edhe pronari i dytë, Dylber Jaçi, po nga Vlora.

Asnjë nga të mbyturit e tjerë nuk është gjetur. Të afërmit edhe sot nuk dinë mbi fatin të viktimave. Ndërkohë autoritetet janë ngushëlluar me zbardhjen e ngjarjes dhe me gjetjen e përgjegjësve të asaj tragjedie në detin me dallgë. E vetmja kufomë e gjetur është ajo e 50 vjeçarit nga Dibra, i cili, sipas deponimeve të të afërmve, vuante nga zemra dhe nuk rezulton të jetë mbytur. Gjithë të tjerët kanë përfunduar në fund të detit.

Gazeta "Ballkan", 4 mars 2004

MINISTRI IGLI TOSKA NË KUVEND!

Në këtë paraqitje që është e para që bën një Ministër Rendi në Kuvend për këtë problematikë që ka penalizuar Shqipërinë prej vitesh e vitesh, do të isha i padrejtë të mos përmendja edhe tragjedinë e 30 dibranëve në 09 mars 1996 që u mbytën; askush nuk tentoi t'i shpëtonte dhe mizorisht fakti iu fsheh publikut dhe familjeve të tyre!

E enjte, 15 janar 2004

PËRFUNDOJNË HETIMET ?!

29.03.2005

Ministri i Rendit Publik, Igli Toska, ka shkuar sot paradite në Maqellarë të rrethit të Dibrës, për të informuar familjarët e 29 personave të humbur në 10 mars të vitit 1996 në detin Adriatik, mbi përfundimin e hetimeve të bëra nga strukturat e Policisë së Shtetit mbi fatin e këtyre personave.

Hetimet rreth kësaj ngjarjeje të rëndë u rihapën pas interesimit të Kryeministrit Fatos Nano dhe urdhrit të ministrit të Rendit Publik, disa muaj më parë, për t'u dhënë një



Pamje nga Maqellara

përgjigje kërkesave të familjarëve, që prej 9 vjetësh nuk kishin asnjë informacion për fatin e njerëzve të tyre.

Hetimet janë kryer në bashkëpunim të ngushtë me policinë e Italisë dhe Greqisë, duke kontrolluar të gjithë dokumentacionin e kohës kur ka ndodhur ngjarja, madje duke kontrolluar edhe të gjithë shtetasit e burgosur në burgjet e këtyre shteteve që nga viti 1996.

Ministritë së Rendit në Itali dhe Greqi kanë marrë në intervistë të gjithë shtetasit shqiptarë që janë arrestuar në periudhën e lartpërmendur.

Në përfundim të hetimeve rezultoi se të 29 shtetasit nga Maqellara e Dibrës dhe tre personat që drejtonin skafin nga Vlora janë mbytur. Nga kontrolli i dokumentacionit përkatës rezultoi se në vitin 1996 Policia Italiane ka njoftuar Policinë e Vlorës për gjetjen e dy kufomave me emrat Sulejman Qoku dhe Petrit Qoku nga fshati Kllobçisht i Maqellarës dhe më pas edhe katër kufoma të tjera të cilat nuk mund të identifikoheshin për shkak të dekompozimit.

Prokuroria e rrethit Vlorë ka nisur procedimin penal për këtë çështje të cilën e ka pezulluar në 10 tetor 1996. Personat që kanë luajtur rolin e sekserëve në grumbullimin e njerëzve, janë amnistuar në vitin 1997 nga presidenti i asaj kohe.

Sot ministri i Rendit Publik ishte në familjen Abdulla Hakorja, i cili ka humbur djalin në këtë ngjarje tragjike. Ndërsa u ka dhënë familjarëve lajmin e hidhur ka qenë i pari që i ka ngushëlluar sipas zakoneve të vendit. Ministri Toska ka premtuar në emër të qeverisë se do të shihen të gjitha mundësitë për të ndihmuar financiarisht fëmijët e viktimave.

MOTRA E DY VËLLEZËRVE

Kreu i komisionit parlamentar të Rendit e SHISH-it, Neritan Ceka,u shpreh dje për gazetën "Ballkan", se po dje i kishte kërkuar takim motra e dy vëllezërve të humbur gjatë tragjedisë së 9 marsit 1996 në Otranto.

"E prita dhe dëgjova shqetësimin e saj, madje i kërkova edhe një shkresë ku të paraqiste ankesën përkatëse. Ajo më vuri në dijeni për ato që dinte dhe për dyshimin se vëllezërit e saj janë gjallë dhe mbahen të mbyllur në një kamp, por që nuk mund të jetë e besueshme", tha kreu i komisionit, Ceka. Por ende nuk ka ndonjë material konkret për këtë ngjarje, pasi janë edhe shumë viktima. Ceka pohoi se e afërmja e dy vëllezërve të zhdukur në këtë tragjedi ishte ankuar edhe pas ngjarjes tek ish presidenti Berisha dhe ky i fundit i kishte dhënë përgjigjen se "deti ka ngrënë dhe do të hajë shumë viktima". Do të interesohem vetë për këtë ngjarje për t'i mësuar të vërtetat', përfundoi kryekomisioneri Ceka.

"Ballkan" 4 mars 2004, f. 7

DITAR '96

-Fletë nga ditari i një gazetari profesionist.

-Denoncohen me emër dhe adresa njerëz dhe institucione që fshehën dhe fshehin 9 Marsin e "djemve të Dibrës". Mes tyre Sali Berisha, Tritan Shehu, Bashkim Gazidede, Luan Lazimi, Sokol Mulosmani... Nuk lihen mënjanë edhe krerët e PS, asokohe në opozitë.

-A ka racizëm në trajtimin që i është bërë dhe i bëhet Dibrës dhe dhimbjes së saj të tejskajshme ?...

Gazeta "Intervista e emigrantit", 3 dhjetor 2004

LETËR E HAPUR MINISTRIT TOSKA...

...Si përfundim kam edhe një merak që ka të bëjë me qeverinë dhe qeverisjen tuaj. Çdo vit, në muajin mars, në bregdetin e Vlorës bëhen homazhe dhe hidhen lulet e pranverës për djemtë e Vlorës që humbën në tragjedinë e njohur. Pashë para disa ditësh që një tufë me lule hodhi edhe kryeministri Nano. Do të ishte e udhës, që të paktën këtë vit kur ngjarja dibrane tashmë është "zbardhur", të vinin në breg të Vlorës e të vajtonin edhe nënat, motrat dhe gratë e atyre djemve të rinj që humbën midis atyre dallgëve të nëmura. Do të doja që tek Ura e Topojanit mbi Drin, të gdhendeshin në shkëmb, në një memorial, emrat e atyre djemve dhe 4-5 ditë para ditverës të hidheshin në Drin për tu përcjellë në det kukrekët, lulet që çelin nën dëborën e marsit në Dibër.

2 prill 2005

(Vijon në faqen 7)

DESHMONI!

Në kujtim të 32 dibranëve të zhdukur në ujërat e Otrantos në natën e 9 marsit 1996, po përgatitet një një libër. Ftojmë të gjithë familjarët, të afërmit dhe të tjerë që kanë dijeni për këtë ngjarje të përcjellin në adresën e gazetës "Rruga e Arbrit", fotografi, shënime për jetën e personave, dokumente, kujtime, etj. Le të jetë ky libër një lapidar për ta.

Adresa: "Botimet "m&b", Rr. "Zenel Baboçi", Pall. "Ferar", Tiranë.
(Për gazetën "Rruga e Arbërit") .
E-mail: **rrugaearberit@gmail.com**

DIBËR E MADHE – PUSHTETI VENDOR ME KËSHILLTARË TË JASHTËM

Diaspora më afër vendlindjes

Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës, gjatë një takimi me gazetarë, deklaroi se në kuadër të platformës të përgatitur për zhvillimin ekonomik të Dibrës, arritëm që në këtë periudhë të promovojmë katër zona ekonomike.

"Tashmë këto zona ekonomike janë të realizuara edhe me plane detale urbanistike e për t'u bërë realitet duhet të thithim investime të huaja. Për këtë qëllim, theksoi Fida," ne kemi vendosur që kryetari i komunës të ketë katër këshilltarë nga diaspora për lobimin dhe thithjen e investimeve të huaja, dy prej të cilëve do të jenë nga SHBA dhe dy nga Evropa, përkatësisht njëri nga Italia dhe tjetri nga Gjermania ose Zvicra".



Biznesmenit IBrahim Kolari



Kryetari i komunës, Argëtim Fida

Ai me këtë rast shpall publikisht Ibrahim Kolarin, biznesmenin dibranoamerikan të parin invesatitor në Dibër, përndryshe edhe kryetar të Shoqatës Atdhetare Dibrane në Nju Jork, këshilltarin e tij për thithje të investimeve nga diaspora. "Këshilltarin tjetër së shpejti do të ma delegojë Shoqata Atdhetare Dibrane në Nju Jork,varësisht nga vlerësimet e tyre se cili do të jetë personi më i përshtatshëm që mund të kontrobuojë maksimalisht për këtë punë", tha kryetari actual I Dibrës.

Fida ka kërkuar dhe nga Shoqata e dibranëve në Itali "Korabi", që edhe ata ta përzgjedhin dhe të delegojnë një anëtar si këshilltar i tij nga Italia.Ndërkaq me që bashkëvendasit tanë në shtetet tjera në Evropë nuk kanë shoqatat e tyre, do të kërkojmë edhe një person në Gjermani apo në Zvicër që është në rrjedha për këtë punë dhe kështu do ta kompletojmë ekipin me të cilin kryetari i komunës do të ketë kontakte të përditshme me internet, me telefon, por edhe me vizita, që këto zona ekonomike të shpallura të bëhen realitet, duke krijuar edhe vende të reja pune", tha fund Argëtim Fida.

Rexhep TORTE

Gropat në rrugën Dibër e Madhe- Strugë

Rrezik për automjetet në qarkullim



Kohëve të fundit shumë banorë të Dibrës së Madhe janë paraqitur në korrespondenturën tonë për të shprehur indinjatën dhe shqetësimin e tyre për gropat në rrugën Dibër e Madhe -Strugë, përkatësisht në segmentin rrugor Dibër e Madhe - Gllobojçicë-Llukovë, që shkatërrojnë gomat e automjeteve, amortizojnë automjetet dhe rrezikojnë jetën e njerëzve.

Ky segment rrugor përveç rrugës së ngushtë me gjerësi 5 metra në gjatësi afër 20 kilometra, është përplot me gropa që paraqesin rrezik të vazhdueshëm për automjetet që lëvizin në këtë drejtim.Vënde vënde ka edhe rrëshqitje gurësh, siç ishte rasti i këtyre ditëve te Ura e Trebishtit.

Ky segment rrugor në drejtim të Strugës dhe segmenti rrugor Dibër e Madhe-Zhirovnicë në drejtim të Shkupit, ishin të vetmet segmente rrugore në Maqedoni por dhe në Ballkan me gjerësi të rrugës 5 metra, që pasqyronin egërsinë dhe padrejtësinë e ish sistemit monist ndaj Dibrës. Rruga Dibër e Madhe - Zhirovnicë u zgjerua dhe përfundoi në fundvitin që shkoi,ndërkaq ky segment rrugor në drejtim të Strugës sot e kësaj dite ka mbetur ende me gjerësi 5 metra dhe i parikonstruuar.

Mbetet detyrë e Qeverisë së Maqedonisë, e Ministrisë për Komunikacion e Lidhje dhe e Fondit për Rrugët Rajonale e Magjistrale që sa më shpejt të kryejë rregullimin e kësaj rruge.

Në komunat Dibër e Madhe dhe Qendrën e Zhupës dhe Marovë-Rostushë që gravitojnë nëpër këtë rrugë, janë regjistruar mbi 6000 automjete të lehta dhe mbi 200 automjete të rënda që paguajnë taksën rrugore të rregjistrimit të automjeteve, por për fat të keq qarkullojnë nëpër rrugë kaqë të vështira.

R.TORTE

SHËNOHET 100-VJETORI I KONGRESIT TË DIBRËS

Festim dhe ndriçim shkencor i ngjarjeve

Në organizim të manifestimit të 100-Vjetorit të Kongresit të Dibrës 1909, më 31 janar 2009, në kabinetin e kryetarit të Komunës Dibër e Madhe, më datë 31 janar 2009, u takuan përfaqësuesit nismëtarë nga Dibra e Madhe dhe Tirana.Grupin nga Dibra e Madhe e përbënin Dr. Argëtim Fida, kryetar i Komunës Dibër e Madhe, Nizamedin Papraniku, kryesues i Këshillit të Komunës, Mr. Ruzhdi Lada, myftiu i Dibrës së Madhe dhe Dr.Prof.Mahmud Hysa, eseist dhe publicist dibran. Ndërsa grupin nga Tirana e përfaqësonin Dr. Arjan Kadiu, kryetar i Shoqatës "Bashkësia Dibrane", Aziz Ndregjoni, nënkryetar i kësaj shoqate, Dr. Nuri Abdiu, kryetar i "Shoqatës së Intelektualëve Dibranë" dhe Bujar Karoshi, anëtar i Këshillit botues të Gazetës "Rruga e Arbërit.". Qëllimi këtij takimi ishte bashkërendimi i punëve për të festuar 100-Vjetorin e Kongresit të Dibrës në korrik të vitit 2009.

Në këtë takim u diskutua për manifestimin e Kongresdit të Dibrës, me theks që manifestimi kryesor të mbahet në Dibër të Madhe dhe pastaj edhe në Peshkopi dhe Tiranë.

Dr. Argëtim Fida me këtë rast tha se komuna e Dibrës së Madhe dhe Qeveria e Maqedonisë, kanë shpreshur interesim dhe gatishmëri për mbështetjen e këtij manifestimi. Ndërkaq përfaqësuesit nga Tirana theksuan se kanë sinjale pozitive dhe shpresojnë se edhe Qeveria e Shqipërisë do ta mbështetën këtë manifestim.

Gjatë diskutimit u shtruan çështje të ndryshme të organizimit si edhe rrugët dhe modalitetet, në mënyrë që veprimtaritë të kenë një vazhdimësi festive dhe përmbajtësore e të mos ketë ripërsëritje.

U fol edhe për përfshirjen e studjuesve dhe historianëve eminentë për të sjellur fakte të reja që e ngrenë në piedestal më të lartë këtë ngjarje me rëndësi të madhe kobëtare shqiptare.

Kongresi I Dibrës 1909 kanalizoi përpjekjet e të gjitha forcave politike shqiptare drejt synimeve të lëvizjes kombëtare shqiptare, u sanksionua vendimi programatik kombësia e përbashkët pa dallime fetare , u sanksionua edhe mbështetja e fuqishme për alfabetin shqip dhe futjen e gjuhës shqipe në shkollat e atëhershme shtetërore.

Më pas përfaqësuesit nga Tirana zhvilluan një takim edhe në Myftininë e Dibrës,ku ndër të tjera u fol edhe për rëndësinë e këtij Kongresi të rëndësishëm mbarëkombëtar.

R.TORE

ETHET PARAZGJEDHORE

Dibër e Madhe - 6 kandidatë për kryetar komune

Të Dibër të Madhe tashmë kanë filluar ethet parazgjedhore që dëshmohen me aktiviotete të shumta të partive dhe individëve pretendues për zgjedhjet locale dhe presidenciale, të cilat në Republikën e Maqedonisë do të mbahen më 22 mars të këtij viti.

Për garën për kryetar të komunës në Dibër të Madhe janë paraqitur 6 kandidatë, prej tyre vetëm një kandidat i pavarur. Sipas Ilir Camit, kryetar i Komisionit zgjedhor komunal, për kryetar komune do të garojnë Dr. Argëtim Fida, kandidat i BDI-së, Petrit Klenja, kandidat i PDSH-së, Bajram Capa, kandidat i DR, Garip Imerovski, kandidat i PEI, Rakip Maloski, kandidat i VMRO-DPMNE, dhe Dashamir Marku, kandidat i pavarur. Për këto zgjedhje listat e kandidatëve për këshilltarë i kanë paraqitur nëntë parti politike, BDI, PDSH, DR, PEI, VMRO-DPMNE, LSDM, PPD, PBKT dhe PBER-partia e romëve.

Dibranët e Dibrës së Madhe në këto zgjedhje kanë edhe kandidatin e tyre bashkëvendas, dibranin Agron Buxhaku për president të Republikë së Maqedonisë, si kandidat i BDI-së.

Ndërkaq në Komunën Qendra e Zhupës për kryetar komune janë paraqitur vetëm dy kandidatë, Mazllum Hasan, knadidat i PDT dhe Arjan Ibrahim knadidat i PPKT. , e mbështetur nga PEI. Sipas Havza Rexhep Rakel, kryetare e Komisionit komunal zgjedhor, me lista të kandidatëve për këshilltarë në këto zgjedhje do të paraqiten BDI, PDT dhe koalicionet LSDM-PLD dhe PBKT-PEI.

Rexhep TORTE

Pajtohuni në gazetën "Rruga e Arbërit"

www.dibra.org

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

*Pajtimi në gazetë kushton 600 lekë në vit dhe gazeta ju vjen me postë në shtëpinë tuaj**

Tel. (04) 22 33 283.

E-mail: rrugaearberit@gmail.com.

Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

* Për ata që duan që gazeta t'ju shkojë me postë në shtëpi, ju lutem konfirmoni në redaksi adresën e saktë

TË VËRTETA DHE MITE PËR "DJEMTË E DIBRËS"

(Vijon nga faqja 5)

EDUART SULA, I MBIJETUARI I 28 MARSIT '97

Ulur në një ballkon lokali që zgjatet mbi det, fytyrëndriçuar nga shpata rrezesh dielli në perëndim, në shoqëri të Shpëtimit, Eqremit dhe Eduartit, gjerbim kafenë e ngrohtë servirur nga Lenci. Një çast i bukur meditimi dhe çlodhjeje. Eduart Sula më përmend Ostrenin e Vogël dhe të dy, pa u "marrë leje" të pranishmëve ngjitemi në atë kodër të bukur me shtëpi në dy pode, tipike gollobordase, zbresim poshtë për të pirë ujë të pastër gurre, ujë që i jep gjelbërim luginës deri në Tuçep e Lladamericë, madje edhe tej kufirit shtetëror, ujë që jep edhe dritë nëpërmjet hidrocentralit të Tuçepit, takohemi me Fitim Sulën dhe Duro Ibrahimin, skulptorë dhe piktorë të njohur në Dibër...

Dhe ndërsa biseda jonë, tashmë përballë diktofonit, ecte për t'u ndalur në punën dhe biznesin e Eduartit në Saranti, fshatin e bukur piktoresk në bregdetin e krahinës së Thivas, në mes na futet një ngjarje që do të më lindte dhembje e do të mi mbushte sytë me lot.

Nuk e kisha jetuar pranë e pranë tragjedinë e 28 marsit 1997. Nuk isha në Shqipëri, isha në një ishull të Greqisë fare pranë Athinës, në Salaminë ku lajmet nga Shqipëria vinin të komentuara nga gazetarë vizivë grekë që ato ditë të kobshme mbulonin tërë jugun e Shqipërisë, krismat dhe gjëmimet e të gjitha llojeve të armëve, tragjedinë kombëtare shqiptare. Gazetat e pakta shqiptare asokohe ishin të ndaluara të dilnin në tregun e Tiranës e jo më të vinin në Greqi. BBC dhe VOA, të vetmet që kishin zë deri tek ne, ato ditë nuk thanë thuajse asgjë për tragjedinë e 28 marsit...

Më vonë do të lexoja për ngjarjen, por në kujtesë gjithçka do të kalonte si një "udhëtim në mjegull"...

Kur Eduarti u fut thellë ngjarjes nuk guxova ta ndërpres. E lash të flasë i ngushur mes kujtimesh e lotësh. Dhe ndërsa ai fliste unë herë e dëgjoja e herë fluturoja kujtimesh të dhembshme të marsit 1996, të një viti më parë, të atij marsi që Otrantoja i kishte marrë tridhjetë djem dibranë varr i të cilëve u bë deti i zi. I bashkova të dy dhembjet dhe u ngusha në një rrëke lotësh. I përjetova atë ditë. Po i përjetoj edhe sot tek zbardh në letër tregimin e gjallë nga një i mbijetuar i tragjedisë që ndodhi dhjetë vjet të shkuara...

Lexuesin do ta ftoja që, nëse e ka detin pranë, të këpusë një lule të freskët e ta hedhë mbi ujë në kujtim të të gjithë atyre që humbën jetën mes ujërave të zeza të kohës sonë. Dhe në qoftë se nuk e ka detin pranë të ngjitet në një kodër dhe të ulë për disa sekonda kokën në shenjë kujtimi për të gjithë ata që humbën jetën, jo vetëm deteve por edhe maleve të emigracionit shqiptar në kohëkalimin midis dy shekujve...

Eduarti tregon:

Në vitin 1994 u martova. Martesa pati një djalë. U kthyem në Shqipëri për të punuar e jetuar atje... (tund kokën mendueshëm dhe sytë ia mbërthen detit, diellit në perëndim)

...Nëntëdhjeteshtata na i prishi të gjitha planet, të gjitha ëndrrat. Filluan trazirat. Humbëm shumë lekë nëpër firma. Jeta u bë shumë e rëndë. Nuk mund të jetonim më prapë aty. Nuk na mbante dot më vendi. Na lindi ideja të largoheshim, të iknim prapë, bashkë me familjen, me gruan dhe me djalin. Të shpërnguleshim, të iknim diku në një shtet që mund ta quanim një çikë më evropian, më të lirë. Në Greqi emigrimi ishte më i mbledhur, më i kontrolluar, më i vështirë, kishte racizëm dhe ksenofobi më shumë se sa në vendet e tjera të Evropës. E vendosëm të iknim në Itali edhe për shkak të asaj gjendjeje që u krijua me krismat, hasmëritë, vrasjet, dhunimet e ndryshme që shfaqeshin kudo gjatë janarit, shkurtit, marsit. Vendosëm të iknim në Itali me anije, me skaf me çfarë të mundnim. Këtë mënyrë e gjetëm nëpërmjet një anijeje në Vlorë, më 28 mars 1997, bashkë me familjen time, me djalin e xhaxhait 17 vjeç, me vëllanë tim Fiqiriun. Ai nuk donte të shpërngulej, donte të më shoqëronte deri në Itali dhe të kthehej prapë, por s'ishte e shkruar të ndodhte ajo...

Erdhi kjo, anija e zezë siç i thonë dhe na mori. Ishim gjithsej 105 veta në anije. Jemi nisur nga moli i Vlorës drejt Italisë nga ora tre e gjysmë – katër, mbas dite. Pothuajse të gjithë njerëzit ishin me familje, me fëmijë, njerëz që donin tu largoheshin trazirave, zhurmës së madhe që kishte kapur Shqipërinë në ato ditë...

Duke ecur në det, pas dy orësh na shfaqet një anije e madhe italiane e cila ishte brenda ujërave shqiptare, mbrapa Sazanit dhe po na shoqëronte. Na bënte sinjale që ne nuk i kuptonim nëse duhet të ndalonim apo jo. Deri në këtë moment ata ishin shumë paqësorë. Po ashtu edhe ne duke ngritur flamurin e bardhë, duke nxjerrë e treguar fëmijët në bord. Në një moment na lë kjo anije dhe shikojmë që drejt nesh po vinte një anije, nga ujerat italiane drejt ujërave tona. Kjo ishte anija ushtarake "Sibila"...

...Gruaja, djali dhe djali i xhaxhait tim, u gjendën, kurse vëllai nuk u gjend se ai ishte lart në bord. Të gjithë ata që humbën ishin ata të bordit që qëndronin në anije sipër. Vëllai im dhe 23 të tjerë nuk u gjendën. Ata u shpallën të humbur....

a_ashiku@yahoo.gr

DËSHMI NGA HIDËR BUCI

...32 klandestinë dibranë u kapën nga policia bregdetare e Korfuzit, ditën për diell, nën xhirimet e kamerave dhe transmetimet e rrjeteve televizive greke, për t'u mbuluar pastaj me heshtje e keqinformim, derisa u sajua legjenda e "mbytjes" së tyre, për të zhdukur përgjithmonë 32 jetë njerëzish të pafajshëm, të izoluar kushedi se ku për të mbuluar një histori që bie erë! Çfarë bën shteti shqiptar, strukturat e tij që nuk hapin një hetim të hollësishëm për të zbardhur të vërtetën dhe për të mbyllur një histori ankthi, vuajtje e dëshpërimi për familjarët e atyre që i hipën skafit për një jetë më të mirë, por nuk dihet se ku përfunduan dhe se çfarë llogarish po kalkulohen me jetën e tyre aq të re, aq të pafajshme!?

"SOT", 15 mars 2008

* * *

Ka dhjetë vjet që ngrejë zërin në të gjitha instancat e sigurisë greke, atyre shqiptare, në strukturat përkatëse të BE-së, në zyrën e FBI-së në Ambasadën Amerikane në Athinë etj. për një nga ngjarjet më enigmatike dhe më të rënda të këtyre viteve të lëvizjes së lirë. Është fjala për zhdukjen enigmatike dhe mbulimin me heshtje,deformim informacioni e shmangie të së vërtetës të 32 klandestinëve që u zhdukën në mënyrën më mafioze, duke mbuluar me mjegull e mister korridorin politik Athinë-Tiranë.



Në foto: Hider Buci në Maqellarë, me të afërm të të zhdukurve në Otranto

Dosja e 32 dibranëve të zhdukur në mënyrën më misterioze në mars të vitit1996 dhe të deklaruar nga instancat shqiptare si të mbytur në ujërat detare italiane, përbën një nga dosjet më të ngarkuara emocionalisht dhe më të keqpërdorura, ku përzihen afera të rrezikshme të botës së krimit politik.

E vërteta është krejt ndryshe nga sa deklarohet nga institucionet shqiptare dhe greke dhe mjafton një hetim i plotë i ngjarjes me synimin për të zbardhur të vërtetën për të kuptuar paradoksin e kësaj ngjarje të paprecedentë…

Bota e emigrantit, Nr. 1, maj 2008

Puna e dituria janë burim jete e lumturie

ME RASTIN E PËRVJETORIT TË MËSUESIT TË MERITUAR HAMIT BAJRAKTARI

Nga: **ISA HALILAJ**
Mësues i Merituar

Umbush një vit pa mësuesin Hamit Bajraktari, po sa herë kujtohet emri i tij, arratiset 'harrimi', e të gjithë ata që e kanë njohur përulen me respekt para kujtimit e punës së ketij burri të ditur.

Mësues Hamiti në origjinë i përket një familje atdhetare. Trashëgon emrin dhe historinë e Bajraktarit të Rrafshit të Lumës, një nga udhëheqësit e dëgjuar popullor në luftërat kundër pushtimit osman e atij serb. Vërtetë trashëgonte emrin, po jo bajraktarizmin, të cilin e zëvendësoi me misionin e mësuesit dhe edukatorit atdhetar.

Hamiti u lind ne Bicaj të Kukësit më 1928. Shkollën fillore plotore e kreu në vendlindje e në vitet 1941- 1943 vijoi gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren, bashkë me shokët lumjanë si: Osman Palushi, Nexhip Visha e Tahir Domi. Aty zuri shokë të ngushtë Xhavit Spahiu, Kolë Shirokën, Isni Hashanin e të tjerë personalitete të njohura në jetëm patriotike shqiptare.


Më 1948 Hamiti me një grup shokësh nga Kukësi si Shefqet Hoxha, Zija Shehu, Besim Spahiu, Safi Korbi, Qemal Mataj, Maxhun Peka etj. vazhdon e mbaron me sukses Shkollën Pedagogjike të Peshkopisë, një nga shkollat e mesme për mësuesi më me autoritet në verilindje. Më 1952 maturantët e Pedagogjikes emëroheshin në punë direkt nga Ministria e Arsimit. Hamitit i takoi të emërohet mësues ne Kolgecaj, ku dha provat e një mësuesi edukator të përkushtuar. Nga kjo me hapjen e shkollës 7-vjeçre në Shipshan, Hamitit do ti besohej detyra e drejtorit të shkollës, e për këtë do mbahet mend me admirim për seriozitet e korrektësi nga ish nxënës e prindër të Shipshanit të Tropojës.

Nga viti 1954, për 12 vjet me rradhë ai dha mësim lëndën e kimisë, biologjisë e praktika mësimore në Shkollën 11-vjeçare të Kukësit, duke u shquar si mësimdhënës profesionist me rezultate të mira, aq sa nxënësit e tij, në arsimin e lartë nuk do te hasnin vështirësi deri në diplomim. Qe mësues kurajoz, studiues i zellshëm dhe komunikues me kolegët në shkëmbimin e përvojës. Gjatë kësaj kohe me përshpejtim kreu dhe studimet e larta për biokimi në Tiranë.

Më 1966 u dërgua mësues në zonën e Bushtricës, ku shërbeu disa vite e me përvojën e mirë të tij, la gjurmët e një pune të mirë jo vetëm si mësimdhënës por dhe si edukator i palodhur në vënien në jetë të njohurive shkencore në terrenin praktik të Bushtricës, gjë të cilën nuk kishin arritur ta bënin të tjerët. Edhe sot, pas gjithë atyre viteve, të shkolla e mesme e Bushtricës, veç inventarit të pasur të kabinetit mësimor të biologjisë, do të gjesh kopshtin eksperimental me toponimin "Bahçja e mësues Hamitit" me një sipërfaqe prej afro 1 hektar tokë ku ai bashkë me nxënësit punëtorë e të zellshëm arrijnë të realizojne një parcelë natyrore të mësimeve praktike të botanikës, me kultivimin e mbi 500 rrënjëve pemë frutore si mollë, dardhë, ftonj, qershi etj. dhe lehëza prodhuese e eksperimentale të perimeve, farishteve, luleve dhe llojeve të drithërave deri te kultivimi i kërpudhave. E gjithë kjo punë i dha emër e vlerësim Hamitit jo vetëm tek nxënësit por dhe tek fshatarët e zonës së Bushtricës,të cilët kur zihet në gojë Hamit Bajraktari shprehen "Mësues Hamiti ha bukë veç, ai i ka të rrallë shokët si mësues dhe edukatorë"

Me moton e punës së tij, Hamiti udhëhiqej nga parimi se "mësuesi kudo që të punojë duhet të lërë gjurmë të mira, e të lërë diçka të mirë për të tjerët. Unë, vinte në dukje ai, kam pas gjithnjë besim tek nxënësit, i kam dashur dhe respektuar ata dhe prindërit të tyre, e kam marrë prej tyre të njëjtin vlerësim." Me këtë sens pune, duke vlerësuar punën e kolegëve të shumtë të tij që nga Burhan Hoti, Shefqet Hoxha, Mustaf Cena, Myftar Halilaj, Naim Manaj, Fejzullah Gjabri etj, i mbylli vitet e fundit para pensionit në shkollën e mesme të Gostilit ku dhe aty la gjurmë të pashlyeshme pune, edukimi e përkushtimi në punën e mësuesit. Ai duke qenë njeri i punës, fjalëpak e punëshumë, komunikues i ëmbël, shpirtmirë dhe shakatarë e i shkathtë fiksoi në mendjen e nxënësve dhe të prindërve të Gostilit se vetëm puna e dituria janë burim jete e diturie.

Proçeset demokratike e gjetën mësues Hamitin në aktivitetin familjar, si pensionist i apasionuar në punërat e bujqësisë por dhe në jetën shoqërore. Ai si figurë e njohur e me personalitet, përkrahu dhe iu përkushtua jetës demokratike të re si person dhe familje. Fjala e tij me peshë dhe respekt në komunitetin e Bicaj, ishte dominuese jo vetëm te të moshuarit por dhe te brezi i ri.



Një vit më parë, në kulmin e dëshirave e ambicjeve për një jetë e punë produktive në afirmimin e normave demokratike, mësues Hamiti krejt papritur dha jetë, duke lënë një boshllëk të pariparueshëm jo vetëm në familje por dhe në rrethin shoqëror që e ka respektuar pa ngjyrime politike. Me kujdes të veçantë i organizuan një komemoracion varrimi me një respekt të veçantë. Të gjithë bashkëfshatarët, kolegët e ish nxënësit e tij të shumtë, edhe sot pas një viti, e sa herë që do ta kujtojnë, përulen me respekt të thellë për këtë burrë të ditur, për mësuesin e tyre që nga 1994 mban denjësisht titullin "Mësues i Merituar".

Rruga Arbërit nr. 34
speciale

Një ditë me gazetarin shqiptar Erol Bala në supergjigantin televiziv FoxNews në New York

"Ëndrra ime të kem një program timin në këtë gjigant mediatik"

Nga: **BEQIR SINA**, New York

Kujtdo që do të më pyeste se ç'do të shkruaja për gazetarin shqiptaro-amerikan të FoxNews, Eroll Bala, do t'i përgjigjesha: "Për promovimin emrit të tij si gazetar i njërit prej televizioneve kombëtare amerikane nga më të mëdhatë në SHBA". Dhe kjo nuk është pak, mbasi Eroll Bala është gazetari shqiptar i cili qëndron i "fshehur" pas kuintave të FoxNews. Emrin e tij e zbuloi aktori i njohur shqiptar në Nju Jork, Luan Bexheti, i cili njihet me Erollin prej kohësh dhe ata janë bërë shokë të mirë, pra kanë lidhur një shoqëri shqiptarësh në Amerikë.

Teksa isha si i ftuar special i Erollit që të shihja se ku punonte ai, pata rastin të vizitoja një gjigant mediatik në zemër të Nju Jorkut - kanalin televiziv konservator FoxNews. Thënë të drejtën, siç i themi ne shqiptarët," të ik koka", po t`u dha rasti të hysh në ambientet e këtij televizioni. Baza e tij ka më shumë se gjysmën e kateve të një rrokaqielli 80-katësh në sheshin Rockefeller Ceneter, që janë pronë e Foxnews (multi milionerit Rupert Murdoch). Aty janë studiot, redakistë dhe zyrat e administratës në një pallat gjigant që këtu në Nju Jork thirren gradaçiele ose "qiellgërvishtës".

Në hyrjen qendrore, sapo të pyetësh se po kërkoje një punonjës me emrin Eroll Bal, menjëherë të drejtojnë në studion D tek programi më popullor në Amerikë "The Morning With Show - Mike and Juliet". Ndërsa sapo të hysh në studion D dhe gjendesh midis aq gazetarësh dhe teknikësh, natyrisht që menjëherë të shkon mendja se sa të suksesshëm janë sot edhe fëmijët e shqiptarëve në Amerikë, sidomos kur e di faktin se ndonjëri prej tyre ka arritur të depërtoj edhe në këtë gjigant. Erolli na thotë se përgjigjja që flet më së miri për sukseset e shqiptarëve në Amerikë është "Historia e shqiptarëve të Amerikës", që është njëra prej më të rëndësishmeve në gjithë diasporën tonë.


"Për këtë gjë mendoj se së pari duhet t'i jemi mirënjohës këtij vendi të madh, por edhe prindërve tanë, thotë Eroli, duke shtuar se ata, megjithese larg vendit të tyre dhe duke bërë punë të rënda, kaluan gjithë jetën duke punuar për të kërkuar një jetë më të mirë për fëmijët dhe familjen e tyre. Ata gjithçka na e kushtuan ne fëmijëve të tyre. Ata na mësuan që edhe në vend të huaj, ne të rritemi si shqiptarë, me gjuhën, zakonet e traditën shqiptare. Ata sakrifikuan që ne të shkollohemi dhe të edukohemi, megjithëse për vete nuk bënë këtu asnjëherë një jetë më të mirë seç e kishin në vendin e tyre".

Prindërit e mi, thotë ai, erdhën këtu në vitin 1974. Babai e nëna me ne tre fëmijët (tre djem), të detyruar nga gjendja e vështirë ekonomike në ish republikën e Maqedonisë së atëhershme, vetëm e vetëm për të bërë një jetë më të mirë e lëshuan vendlindjen e tyre, Ostrenin, një katund ndërmjet Strugës e Manastirit dhe emigruan në SHBA.

Vetë babai i Erollit bëri punë të ndryshme dhe e ndërtoi jetën e tij, ashtu si edhe familjet e tjera të emigrantëve shqiptarë këtu në Amerikë. Ata bënë gjithçka me djersën e ballit dhe me ndershërinë e tyre vetëm për të na siguruar një të ardhme ne fëmijëve të tyre. Këtë e pranon edhe Erolli teksa thotë se edhe prindërit tanë janë të kënaqur për të vetmen gjë: kur na shohin ne fëmijët e tyre se jemi bërë të paktën të zotët e vetes dhe kemi arritur ndonjë sukses.

Në shtëpi, tregon Erolli, ne bëjmë një jetë tradicionale shqiptare, ashtu si shumcia e familjeve të emigratëve shqiptarë. Shkojmë e vijmë tek njëri-tjetri, takohemi shpesh në dasma e raste të ndryshme. Nëna ime është shtëpiake e mirë dhe gatuan të gjitha llojet e ushqimeve si në fshatrat shqiptare.

Erolli thotë se i pëlqen shumë fshati i prindërve. Ai thotë se është i "dashuruar" shumë pas vendlindjeve të dy prindërve të tij - Manastirit të babait dhe Strugës së nënës. Për këtë edhe në vizitën e fundit në Strugë, Manastir e Ohër ai ka realizuar një dokumentar 10 minutësh, i cili gjendet edhe në Youtube me titull "The Balkan Excursion". Mund të klikoni dhe ta shikoni atë dokumentar që tregon për jetën e banorëve të këtyre anëve, zakonet e traditat e tyre si dhe atë më të shkëlqyerën: bukuritë e mrekullueshme natyrore të këtyre viseve shqiptare, që janë perla të Ballkanit.



Erol në fshatin e prindërve të tij në Strugë - ku edhe ka realizuar dokumentarin "The Balkan Excursion"

Gazetari shqiptar që qëndron i "fshehur" pas kuintave të FoxNews

"Dita e pranimit në FoxNews si gazetar fillestar i tij, për mua patjetër që është njëkohësisht edhe një nga ditët më të gëzuara në jetën time. Qe pesë vjet punoj në këtë kanal dhe tash jam koordinator në disa studio dhe drejtoj disa herë intervistat e emisionit "The Morning With show Mike and Juliet" në realizimin direkt, që bëhet ndodnjëherë edhe në rrugë. Ky është program i mëngjesit i kanalit televiziv FoxNews. Ai fillon nga ora 9:00 deri në orën 10:00 paradite, nga e hëna deri të premten . Kam drejtuar vetëm për FoxNews reportazhin nga Auto Show më të famshëm në New York: "International Auto Show Civic Center", i cili mund shikohet në You Tube "Motor Minute Hosted by Erol Bal".

Duke folur për programin televiziv "The Morning With show Mike and Juliet" në FoxNews, ku ai ka çdo ditë detyrën e koordinatorit të këtij programi, Erolli thotë se ky program transmetohet në gjithë territorin e SHBA-ve dhe ka rreth 15 milionë shikues çdo ditë.

Sipas sondazheve ky program mëgjesi rradhitet, sipas tij, i treti në SHBA dhe është një variete shumë interesante. Ai tregon me shumë pasion se në këtë program marrin pjesë për çdo ditë njerëzit më të famshëm në Amerikë: politikanë, artistë, shkencëtarë, psikologë, ligjëbërës, zyrtarë të lartë amerikanë, talente të jashtëzakonshme si dhe trajtohen edhe probleme sociale e familjare. Pra, është një program tipik edukativ i kanaleve më të mëdha amerikane. Ai shton se ndoshta një ditë në variete do të thërrasë edhe ndonjë shqiptar".

Si pothuaj të gjithë gazetarët e këtij kanali dhe gazetarët amerikanë në përgjithësi, edhe tek Eroll Bala nuk e shihje fare atë prirjen, që fatkeqësisht po e ndeshim sot tek ndonjë gazetar shqiptar, në Shqipëri, që shpie te bindja se po të jesh gazetar - "je njeri i madh, je i plotpushtetshëm".

Gjatë bisedës, duke folur për profesionin e gazetarit, për vendin e gazetarisë në jetën e sotme dhe në realitetet e sotme, në të cilat janë futur edhe gazetarët shqiptarë, gazetari shqiptaro-amerikan Eroll Bala thotë se baza është pavarësia, liria dhe kushtet në të cilat punon gazetari.

Të dy ishim të mendimit se si lajmi "i mirë" dhe ai "i keq" mund të nënshtrohen dhe të përdoren për krijimin e pamjes strategjike dhe se mediat duhet të jenë të lira dhe të tregojnë se si mbrojnë ato lirinë e vet, me atë çfarë shprehet sot solidariteti profesional i gazetarëve dhe pikërisht ky është kriteri për guxim qytetar dhe profesional.

Në ndarje gazetari Eroll Bala na tha se pavarësisht ku dhe në ç'kushte punojnë gazetarët shqiptarë, ata kurrsesi s`duhet të demoralizohen e as të kenë frikë. Ata detyrën e gazetarit duhet ta kryejnë me vetëmohim si mision të tyre profesional e fisnik dhe të jenë sa më shumë njerëzorë dhe të prezantojnë jetën në mënyrë realiste.

I gjithë stafi i kanalit televiziv FoxNews në Nju Jork e di që Erolli është shqiptar

Erolli është i edukuar në shkollat amerikane. Ai ka përfunduar në mënyrë të shkëlqyer, siç tregon vetë, të gjitha shkollat, deri sa ka përfunduar edhe universitetin. Ai tregon se si në shtëpi, sidomos kur kishin gazmende familjare, kur ai ishte i vogël, jo vetëm prindërit, por edhe të afërmit e tij gjithmonë e nxirrnin përpara miqve dhe të afërmve të recitonte, të imitonte dikë nga familja ose të këndonte ndonjë këngë. "Nuk e di se përse, por mua në familje më konsideronin si "një komedian, si një yll kinemaje", shton Erolli për përvojat e veta të para me publikun.

"Mirëpo kjo, sqaron ai, më ka ndihmuar shumë kur sot unë jam bërë gazetar. Pasi fitova shumë dhunti nga ato që do të më nevojiteshin gjatë jetës, deri sa edhe duke u rritur më lindi pasioni të intervistoja ose të drejtoja edhe unë një ditë emisone në radio ose në televizion si gazetar. Sapo përfundova universitetin iu drejtova një radioje të qytetit, këtu në Nju Jork, për punë. Kur mbërrita në dyert e lokalit, kujton Erolli tash, ku ishte atëherë qendra e asaj radioje, drejtuesit e saj kur mësuan se për çfarë kisha shkuar dhe çfarë po kërkoja, u habitën se çfarë lidhje kisha unë me gazetarinë. U thashë me bindje se kisha shumë dëshirë të filloja punën në radion e tyre si spiker ose si gazetar. Përgjigjja e tyre ishte se edhe nëse unë kisha aftësi, përvojë e diplomë dhe e meritoja një vend të tillë pune aty, ata nuk kishin të më paguanin për një vend pune që nuk ma siguronin dot. Siç më sqaroi njëri prej tyre më pas, numri i gazetarëve ishte i "fryrë". Megjithatë, më kushtëzuan duke më dhënë një mundësi se nëse punoja deri sa të lirohej një vend pune, që nuk i dihej se kur, ata do të më mbanin duke provuar njëherësh aftësitë e mia, pasi kuptuan pasionin tim pas gazetarisë. Pranova! M`u desh të punoja tek ajo radio një vit pa asnjë penny (qindarkë) vetëm e vetëm të realizoja ëndrrën time që të bëhesha një ditë gazetar dhe të bindja kolegët e mi për këtë. Sakaq, pas një viti, një mik imi më rekomandoi të kontaktoja me zyrat e kanalit televiziv FoxNews në Manhattan për një vend pune. Shkova dhe mbusha një formular, ku më pas konkurrova për një vend pune aty, të cilin deshi Zoti dhe e fitova".



Beqir Sina dhe kolegu i tij te FoxNews, Erol Bal

"Rinia e sotme, që nxjerr nga gjiri i vet një "Miss Albania" dibrane, e ka vështirë ta konceptojë se sa vështirësi kaluan ato vajza të para të Pedagogjikes për të thyer zakonet e kohës, për tu ngritur mbi ta dhe për të fituar..."



Komuniteti Dibran festoi së bashku me mysafirët e lart nga Kosova Pavarësin e Kosovës në Uashington

Dibranët, rol dhe kontribut të çmuar në pavarësinë e Kosovës

Nga: **BEQIR SINA**

WASHINGTON D. C: Delegacioni i Republikës së Kosovës në Uashington, mori pjesë në shënimin e njëvjetorit të Pavarësisë së Kosovës, të organizuar nga Ambasada e Kosovës në SHBA. Ambasada e Republikës Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, organizoi me 26 shkurt një pritje madhështore me rastin e përvjetorit të pavarësisë në një nga sallat e hotelit "The Embassy Suites" në Ushington D.C.

Në këtë pritje morën pjesë rreth 500 shqiptarë të ardhur këta më së shumti nga shtete të ndryshme të Amerikës. Mes pjesmarrësve dalloheshin grupet e shqiptarëve, të cilët kishin ardhur nga shtetet më të largëta të Amerikës, si Çikagoja, Detroiti, Bostoni, Rhoda Island, Florida, Arizona, Teksasi, Nju Jersey, dhe Nju Jorku. Për të festuar së bashku me udhëheqësit e lartë nga Kosova në përvjetorin e parë të pavarësisë së Kosovës, erdhën në festë edhe lider të njohur komunitetit, krerët e disa komuniteteve fetare prej Detroitit e Nju Jorkut, veprimtarë të dalluar të çështjes shqiptare, afaristë e biznesmen të suksesëshëm, gazetarët shqiptaro amerikan, studentë shqiptarë, artsitë e shkrimtarë, miq amerikan e shumë personalitete të tjera amerikane.

Në këtë pritje morën pjesë edhe dy kongresmenë, miq të dëshmuar të shqiptarëve në Amerikë, republikani nga Kalifornia, Dana Rohrabacher, dhe demokrati i Nju Jorkut, Eliot Engel. Si dhe zoti Soren Jesen-Petersen, ish -përfaqësuesi i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, ish -shefi i Zyres amerikane ne Prishtine Filip Goldberg, Heroi i Reçakut, ish- shefi i misionit të OSBE-së, ambasadori Wlliam Walker, dhe ish ndihmës Sekretari i Departamentit të Shtetit Daniel Frid me disa zyrtarë të lartë administratës amerikane. Përfaqësuesit e shtetit shqiptarë, ambasadori në Nju Jork, Adrian Neritani dhe ambasadori në Uashington Aleksandër Sallabanda, si dhe përfaqësues të korit diplomatik të vendeve të ndryshme, akredituar në Shtetet e Bashkuara.

Pritja e mbrëmshme, erdhi menjëherë pas atyre festimeve madhështore që shqiptarët e Amerikës, kanë bërë gjatë këtyre ditëve në përvejetorin e parë të pavarësisë së Kosovës . Ndërsa, delegacioni nga Kosova erdhi në këtë festë pas atij festimi madhështorë që iu bë 1- Vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, në Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni, Preshevë, Bujanovc, Medvegje , Diasporë dhe viset shqiptare dhe një dite të ngjeshur pune, ku delegacioni nga Kosova, është takuar edhe me disa nga ambasadorët e vendeve të ndryshme të akreditуar në Uashington, që e kanë njohur, ose pritet ta njohin së shpejti Kosovën

Festa në Uashington e çelë teksa një grup i vogël muzikanësh, një grua në piano, një tjetër në violinë dhe një burrë në bas, nën petagramet e muzikës klasike, luajtën intonimin e hymneve kombëtare të Republikës së Kosovës dhe hymnit të SHBA-ës, shoqëruar me një çast solemn nga pjesmarrësit. Ky moment shënoi edhe fillimin e festimit të një vjetorit të pavarësisë së Kosovës, në kryeqytetin amerikan Uashington D.C. Më pas nga podiumi i tubimit, në sallën e hotelit "The Embassy Suites", ambasadori i Kosovës, zoti Avni Spahiu pos që foli për rrugën që ndoqi Kosova drejt pavarësisë së saj, u bëri nga një prezantim dinjitoz edhe Presidentit të Republikës së Kosovës dr Fatmir Sejdiut dhe Kryeministrit Hashim Thaqi. Ambasadori Spahia ka falеminderuar edhe miqt tanë amerikanë të cilët ishin pjesmarrës së bashku me shqiptarët e amerikës në festën e përvjetorit të parë të pavarësisë së Kosovës.

Në këtë festë madhështore morën pjesë edhe një grup nga komuniteti dibran në SHBA-ës, Grupi dibranëve i përbërë nga kryetari i Shoqatës Atdhetare Dibrane, zoti Ibrahim Kolari, veprimtari e biznesmeni i suksesëshëm Ylber Pilku, veprimtarët Habib Karpuzi, Duli Dema, Fuat Dika,Fanol Cami Gazmend Lleshi, ka shfrytëzua këtë takim festivë, të përcjell në emër të komunitetit dibran në SHBA-ës, urimet më të mira për 1-Vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Ata u takuan dhe shkëmbyen fjalë miradie me Presidentin e Republikës së Kosovës dr Fatmir Sejdiun, Kryeministrin e R. Kosovës, zotin Hashim Thaqi dhe me kongresmenin republikan nga Kalifornia, Dana Rohrabacher, dhe demokrati i Nju Jorkut, Eliot Engel. Si dhe zoti Soren Jesen-Petersen, ish -përfaqësuesi i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, ish -shefi i Zyres amerikane ne Prishtine Filip Goldberg, Heroi i Reçakut, ish- shefi i misionit të OSBE-së, ambasadori Wlliam Walker, dhe ish ndihmës Sekretari i Departamentit të Shtetit Daniel Frid me disa zyrtarë të lartë administratës amerikane. Përfaqësuesit e shtetit shqiptarë, ambasadori në Nju Jork, Adrian Neritani dhe ambasadori në Uashington Aleksandër Sallabanda, si dhe përfaqësues të korit diplomatik të vendeve të ndryshme, akreditуar në Shtetet e Bashkuara.

Ata gjatë bisedave me miqt e shqiptarëve në kongres e senat dhe mysafirët e lart nga Kosova, ata arritën të përcjellën mesazhin e dibranëve , për atë çka bëri Dibra për pavarësinë e Kosovës, duke ngritur lart rolin e kontributin e dibranëve. Kolari, kujtoj gjatë bisedave në festë se në shenjë mirënjohje Dibra ka vendosur edhe një pllakat në mes të qyteti ku thuhet se " Dibra e Madhe : Kosove e Vogel - dhe Kosova plage e saj" çka është diçka, kjo shumë emocionale dhe monumentale për atsesa e lidhur është Dibra me Kosovën ."Vetëm, në Nju Jork, tha kryetari i dibranëve në Amerikë, zoti Ibrahim Kolari, mendohet se jetojnë e punojnë rreth 15 mijë, dibranë, të cilët japin një kontribut të çmuar për qytetin e Dibrës. Shumë prej tyre tha ai janë edhe duke investuar në Dibër."

Biznesmeni i suksesëshëm, Yleber Pilku, ka vënë në pah rendesin strategjike, gjeopolitike dhe ekonomike per ndertimin e rrugës së asaj që do të quhet Rrruga e Arbërit." Kur, kjo rruge do te ndertohet, tha Pilku, segmenti Tirane - Diber mund te pershkohet ne me pak se një orë nga 6 orë që përshkohet tani. Dhe nga 180 kilometra ajo do të jetë rreth 75 kilometra". Pilku, gjatë bisedave me miqt amerikan dhe anëtarët e lart të delegacionit nga Kosova , ceku faktin se "Rruga e Arberit" mendohet se eshte gjithashtu mundesia me e lire per t'u lidhur me Kosoven, duke kaluar tranzit ne republiken e Maqedonise" i tha ai në bisedat me me Presidentin e Republikës së Kosovës dr Fatmir Sejdiun, Kryeministrin e R. Kosovës, zotin Hashim Thaqi dhe Ministrin e Jashtëm Skënder Hyeseni.

Fotoalbumi i gazetarit

SHKOLLA PEDAGOGJIKE 1956...

Fotografitë që po përcjell janë pjesë e albumit tim. Nuk janë shkrepje të miat, janë shkrepje të fotoreporterëve të Agjencisë Telegrafike Shqiptare, janë shkrepje të viteve '50-të, të cilat i kam marrë nga arkivi i ATSH-së. Me to do të njihemi në disa numra të gazetës "Rruga e Arbrit" për tua lënë vendin më pas "shkrepjeve të mia" anë e mbanë Dibrës, shkrepje që i kalojnë të tremijtat, që "flejnë" në negativë, shumë prej të cilëve kanë marrë ngjyrë nga e verdha e kohës...
Kësaj radhe po përcjell pesë fotografi nga Shkolla Pedagogjike, e para shkollë e mesme në Dibër, djepi ku u përkund (dhe përkundet) profesioni i bukur i mësuesit.
Ndër ta veçoj njërën, foton ku është Kumria, Sania, Hidja, Tefta...vajzat e para që në vitin 1959 mbaruan Pedagogjiken dhe u bënë mësuese. Ishin vajzat e para që thyen një mentalitet dhe hapën një rrugë të re. Për to u thur këngë dhe u hoq valle...
Kush e mban mend atë këngë?
Rinia e sotme, që nxjerr nga gjiri i vet një "Miss Albania" dibrane, e ka vështirë ta konceptojë se sa vështirësi kaluan ato vajza të para të Pedagogjikes për të thyer zakonet e kohës, për tu ngritur mbi ta dhe për të fituar...
Ndonjë, që e sheh veten dhe e do një fotografi si kujtim për ato vite të bukura të rinisë së tij, është i mirëpritur.











ABDURAHIM ASHIKU
a_ashiku@yahoo.gr

"Po ashtu si rilindësit që zhvilluan paralelisht shumë veprimtari kulturore, Milto S. Gurra na paraqitet si editor dhe publicist, si letrar, prozator dhe poet, si politikolog dhe si përkthyes".

Dy vepra të Milto Sotir Gurrës me procedim romantik

Nga: **Dr. MAHMUD HYSA**

Milto Satir Gurra (1884 - 1972), i lindur në Marjan, Opar, rrethi i Korçës, kishte afërsisht të njëjtën moshë dhe të njëjtin fat të mërgimtarit të përjetshëm me Fan Nolin, ndërsa me veprën letrare ishte ndër shkrimtarët e fundit të Rilindjes Kombëtare me procedime romantike, më parë me Milo Duçin, Josif Haxhidhimën, Namik S. Delvinën, Qamil Çamin, Ramiz Harxhin e tjerë, i afrohet pak Mihal Gramenos, por jo Foqion Postolit, Sterjo Spasses, siç thonë disa studiues. Megjithate, vepra e tij, edhe pse me procedime romantike, e kishte vendin dhe kohën e eksplorimit të saj, kur marrim parasysh shkarjet dhe devijimet në strukturat e caktuara të shoqërisë shqiptare që ngjanë në vitet e para pas pavarësisë e cila kishte nevojë edhe më tutje për një letërsi romantike, që, përmes segmenteve të shumta të jetës, të ndërtojë një vetëdije të qartë kombëtare, në mënyrë që të konstituohej shteti i ri me sa më pak probleme të dilemave të vetëdijes kombëtare me qytetarë që të veprojnë dhe të mendojnë me ndërgjegje kombëtare pa asfare dilemash. Kjo vijë e romantizmit të vonuar paraqitet te shumë popuj edhe në kohët më të vona, madje edhe sot, si dukuri e nevojshme që përplotëson një vakuum të krijuar në kohën e romantizmit të vërtetë, megjithëse sot mund të tolerohet vetëm një romantizëm progresiv.

Ashtu si shumë shkrimtarë të Rilindjes Kombëtare, pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi jashta atdheut në Rusi, kryesisht në Odesa, në Amerikë, Stamboll, Sofje, Kostancë ku pati mundësi të zhvillojë veprimtari krijuese kombëtare më i lirë nga presionet politike turke, ndërsa në kohën e pavarësisë jetoi edhe në Shqipëri që pas vitit 1944 të emigrojë përsëri jashtë atdheut. Po ashtu si rilindësit që zhvilluan paralelisht shumë veprimtari kulturore, Milto S. Gurra na paraqitet si editor dhe publicist, si letrar, prozator dhe poet, si politikolog dhe si përkthyes.

Si editor botoi revistën Atdheu në Kostancë më 1912, revistën Shkëndija në Korçë më 1921, revistën satirike-humoristike Zekthi në Korçë më 1922 dhe revistën Mituria më 1944 dhe si publicist bashkëpunoi me gazetat dhe revistat Dielli të Bostonit 1910, Drita Tiranë 1928, Tomorri, Tiranë 1940, gazetën Gazeta e Korçës, Korçë, 1924, gazetën Drini më 1943, gazetën Populli, Korçë 1914. Më shumë ka publikuar artikuj në revistën Atdheu dhe ka përdorur 22 pseudonime si Misogu, Nomadhi, Gjon Zeza, D.Toçka, Atdhetari, Barleti, Barletius, Grasomi, Mësonjësi e tjerë.

Është marrë edhe me përkthime, kryesisht nga gjuha ruse, ka përkthyer tri drama të Pushkinit, veprat e Turgenjevit, Tostojit, Çehovit, Gorkit.

Si politikolog jep kontribut në ndërtimin e vetëdijes kombëtare me veprën psikologjike-historike-politike: Themelet e Patriotizmës Shqipëtare, Shtypshkronja "Gutenberg", Tiranë, pa vit botimi, por kontribut më të madh dhe më të vlershëm jep në letërsi me veprat: Plagët e kurbetit, (tregime adetesh) I dhe II Tiranë, 1938, Mbi Altarin e dashurisë (tregime dashurie) I dhe II, Tiranë 1938, Kur rilindej Shqipëria (tregime patriotike), I dhe II, Tiranë 1938, Psherëtimet e shpirtit (vjersha), I dhe II, Tiranë 1938, Përrallat e Hall Cepës, I dhe II, Tiranë 1938 dhe Plagët e zemrës, (tregime), I dhe II Tiranë 1944.

> Për të ekzistuar vetëdija kombëtare duhet të ketë tre komponente: historinë, legjendat dhe heronjtë. Në këto tre komponente ndërtohen idealet dhe ëndërrat që e rrisin një popull. Nga historia vërtetohet se shqiptarët janë populli më i vjetër dhe trashëgimtarë të dejtëpërdrejtë të popullit më të vjetër të Ballkanit; ilirëve, maqedonëve dhe mollosëve.

PRAGMATIKA E VETËDIJES KOMBËTARE

Me veprën Themelet e Patriotizmës Shqipëtare, edhe Milto Sotir Gurra u bashkohet rilindësve për poetikën e formimit dhe kultivimit të ndërgjegjes kombëtare te bashkatdhetarët që ose nuk i dinin fare konturat e kësaj vetëdijeje ose ishin me njohuri shumë të cekta dhe kishin nevojë edhe për pragmatikën e tyre konkrete. Në këtë mënyrë do të mund ta stabilizonin në vete një fenomen shumë të rëndësishëm apo të mbronin dhe të kundërshtonin në rast nevoje me argumente faktografike dhe të pakontestueshme diçka që është e njohur nga gjithë bota e qytetëruar se shqiptarët kanë një bazament shumë të shëndoshë të vetëdijes kombëtare, më të shëndoshë dhe më të lashtë se shumë popuj tjerë të Ballkanit dhe të Evropës të cilën shqiptarët duhet ta njohin dhe të krenohen.

Për të qenë vepra më e qartë dhe më pragmatike, autori e ka ndarë në 12 kaptina duke e konsideruar edhe hyrjen si kaptinë në vete. Në tri kaptinat e para elaboron me faktorët psikologjikë: me komponentet që e përbëjnë vetëdijen kombëtare, vazhdon me besën dhe me trimërinë shqiptare për të vazhduar me faktorët historikë dhe politikë që me frymën pragmatike e përforcojnë këtë komponentë të shpirtit të shqiptarit me shembujt më relevantë që rrallë i kanë popujt tjerë. Vepra nuk e ka të shënuar vitbotimin, por me përkushtimin Zogut I dhe me dy kaptinat e fundit, Ahmet Zogu dhe Çpallja e Monarkisë,duhet të jetë në mes viteve 1928-1939.

Sipas këtij autori, për të ekzistuar vetëdija kombëtare duhet të ketë tre komponente: historinë, legjendat dhe heronjtë. Në këto tre komponente ndërtohen idealet dhe ëndërrat që e rrisin një popull. Nga historia vërtetohet se shqiptarët janë populli më i vjetër dhe trashëgimtarë të dejtëpërdrejtë të popullit më të vjetër të Ballkanit; ilirëve, maqedonëve dhe mollosëve.

Për besën shqiptare, autori flet në një kaptinë të veçantë duke depërtuar në psikologjinë e popullit ku manifestohet faktori psikologjik. Autori pranon se jemi edhe na një popull indogjerman, është ithtar i teorisë gjermane dhe jo indoevropiane, por jemi populli i veçantë që ndjenjën e besës nuk kanë mundur të na e shuajnë pushtuesit as të qytetëruar, as barbarë pse e kanë mbrojtur dy faktorë: besa si trashëgimi dhe besa si ndjenjë e ngjizur me shpirtin e shqiptarit. Megjithate, për autorin është vështirë ta ketë ndjenjën e besës një popull, po më vështirë është të dijë ta mbajë gjatë të gjitha fazave të ekzistencës së vet, siç e kanë dëshmuar shqiptarët gjatë historisë që shumë mbretër e sulltanë kanë preferuar të kenë shqiptarë si roje personale apo si roje të gjerave të vlefshme. Po edhe në vetë jetën e shqiptarit autori gjen shumë momente ku manifestohet kjo ndjenjë si dispozitë shpirtërore.

Trimëria, sipas autorit, është një dispozitë tjetër e shqiptarit që nuk e shpreh jetën e qetë dhe të lumtur të një populli, por jetën plot dinamikë, trazira, luftë, rezistencë të gjitha për të mbrojtur lirinë pse vetëm një popull trim siç është populli shqiptar ka mundur t'i rezistojë fuqive më të mëdha të kohës: romakëve, bizantinëve, turqve, sllavëve e tjerë. Trimëria e ka edhe sakrificën, nuk mund të gjesh një Oso Kukë te popujt tjerë. Po besa dhe trimëria ka qenë edhe një kob për shqiptarët se ne kemi luftuar më shumë për të tjerët në Jemen, Rusi, Austri, Hungari, Rumani, Bullgari, Greqi e Sërbi ku kemi dhënë heronj dhe atyre sot të paktën duhet t'u përulemi.

Argumenti i lashtësisë së një populli është faktor me rëndësi për një vetëdije të qartë e të pakonpromistë kombëtare pse ky ndikon në mburrjen dhe në krenarinë kombëtare të cilat janë elemente të patejkalueshme për një vetëdije kombëtare të situuar. Me kaptinën Leka i Madh fillojnë argumente historike për një vetëdije të krenarisë kombëtare duke nxjerrë fakte dhe dëshmi se Olimpia, nëna e Lekës, ka qenë mollose, dialogu i Lekës me Filipin, hypja e tij në fron, pushtimi i Thrakisë, lufta me persët, rruga në Indi, pushtimi i Egjiptit, të gjitha flasin për një figurë autoktone,të pasur dhe zulmëmadhe shqiptare.Një personalitet tjetër e krenarisë kombëtare ka qenë edhe Pirrua i mollosëve që pati guximin të luftojë kundër romakëve. Madhështore është edhe Tefta e Ilirisë që i mati forcat me flotën romake dhe nuk u turpërua. Skënderbeu si figurë madhore, me 30 luftërat brenda 25 vjetëve, ka ndikuar në kenarinë kombëtare. Lidhja e Prizrenit është një pikë kulminante që sublimohet me thënien sipas tij: Nuk durojmë robëri, ashtu siç është edhe Dita e Flamurit kurorëzim i gjithë aspiratave të shqiptarëve, ndërsa si pikë të ndritshme të historisë kombëtare e konsideron edhe Kongresin e Lushnjës pse aty u dha garancioni për lirinë e pavarësinë dhe pushuan armët vëllavrasëse. Kaptina për Ahmet Zogun është në frymën pozitiviste flitet për rolin e tij që në Kongresin e Lushnjës, luftën kundër esadistëve, për kryengritjen e marsit, për triumfin e ilegalitetit, për formën e qeverimit dhe për kryengritjen e qershorit, pa e përmendur fare Fan Nolin, por për Zogun që u tërhoq, pastaj u kthye, u bë president dhe në fund vjen edhe shpallja e monarkisë më 1 shtator 1928 kur, me vullnetin e popullit, Shqipëria shpallet monarki dhe Ahmet Zogu mbret i saj.. Gjithë kjo shkon në vazhdën e politikës së ditës, në mënyrë konformiste dhe pozitiviste, dhe pse sot Zogun e shohim me dioptri tjetër.

KRIJIME LETRARE ME PROCEDIME ROMANTIKE

Përmbledhja në prozë Plagët e zemrës që ka si titull Goca e Kaçanikut, pjesa I, "Gurakuqi", Tiranë, 1944 i përkushtohet nga autori Kujtimit të dëshmorëve që e derdhë gjakun e tyre për ta ngrehur tempullin e fesë së shqiptarizmës, përfshin në vete katër tregime, të gjitha me procedime romantike, të një romantizmi kombëtar, të shkruara në vitet 1911, 1911, 1913 dhe 1915, ashtu siç ishin edhe dramat e Stërmillit, Gramenos ku pasqyroheshin ditët tragjike të popullit shqiptar në kohën e Luftërave Ballkanike kur duheshte të bëhen sakrifica për ta ruajtur gjenen nga shprishja dhe shkapërderdhja që i rrezikohej çdo moment sa nga forcat e jashtme, aq edhe nga ato destruktive të brendshme.



Në foto: Milto Satir Gurra (1884 - 1972)

Tregimi i parë Goca e Kaçanikut ka si temë themelore: rezistencën e armatosur të kosovarëve, kryengritjet e viteve 1910-1912 kundër fushatave ndëshkuese turke për një çlirim kombëtar nga robëria shekullore. Epiqendër e rezistencës është Kaçaniku, madje para nesh dalin edhe fytyra të njohura historike si Bajram Curri, Isa Boletini që si komandantë ushtarakë udhëheqin tërë lëvizjen. Në tregim implikohen edhe tema tjera historike siç është kushtetuta e xhonturqve që ishte një mashtrim perfid edhe pse shqiptarët e pritën sinqerisht me gazmend dhe dhanë kontribut në realizimin e këtij revolucioni. Tema patriotike gërshetohet me një temë romantike, me dashurinë e pastër e të sinqertë të Pafikës me një djalë të ardhur nga kurbeti, por që primare e ka çlirimin e atdheut dhe pastaj jetën personale duke mos e bërë gabimin Milosaut që e la luftën për t'u martuar me Rinën dhe kështu e bëri kobin tragjik, prandaj Milosaos i vdes gruaja dhe djali pse s'ka lumturi personale pa lumturi kombëtare.

Tregimi i dytë Dashuria e Matildës shtron një temë tipike rilindëse se vendi varfërohet edhe nga martesat e djemve shqiptarë me vajza të huaja duke i lënë vajzat shqiptare të pamartuara, një temë që është shumë aktuale edhe sot. Sipas këtij tregimi, dashuria është ndjenjë e fuqishme, por edhe te ajo duhet të veprojë ndjenja kombëtare jo vetëm pse s'mund të ketë lumturi familjare në mes të rinjve kombesh të ndryshme, por edhe për faktin pse varfërohet gjeneja kombëtare.

Tregimi Mbi altarin e dashurisë flet për një çift të dashurish që jetojnë larg njëri tjetrit, prandaj shfaqen shqetësime, paranoja, somnambulizmi, halucinacionet, kllapia, dyshimet, tradhtia pse nuk mund të mendohet për këtë ndjenjë derisa është armiku mbi kokë. Të njëjtën fakturë e ka edhe tregimi Nga balli i luftës.

Tregimet kanë ide mjaft transparente, stili tipik tregimtar, me ndonjë figurë stilistike të gradacionit, me një natyrë që është pjesëmarrëse ose paralajmëruese me shqetësimet e personazheve. Gjithsesi vlen të shqyrtohen edhe veprat e tilla për t'u njohur me preokupimet që kanëë pasur rilindësit për fatin dhe jetën e popullit.

"Ramiz Gjini i qëndron besnik synimit për të na dhënë një vepër realiste me probleme e dukuri të realitetit bashkëkohor".

Tregimtar i fuqishëm dhe jetësor

Shënime për librin "Rrëfime në hije" të Ramiz Gjinit

Nga: **PERIKLI JORGONI**

Libri me tregime "Rrëfime në hije" i shkrimtarit Ramiz Gjini është në vazhdën e vëllimeve të tjerë të hartuara prej autorit, i i cili iu bë i njohur lexuesit që me vëllimin "Dush varrezas" dhe "Këpucët e të tjerëve mbi trotuar". Shkrimtari i qëndron besnik synimit për të na dhënë një vepër realiste me probleme e dukuri të realitetit bashkëkohor.

1.

Përgjithësisht personazhet e rrëfimeve janë njerëz që u duhet të përballohen me jetën dhe vështirësitë e saj. Bota e tyre shpirtërore është e pasur dhe e ndjeshme. Tek ta është e gjallë dashuria njerëzore, nderimi për punën, për njeriun. Tregimet e Ramiz Gjinit janë të freskëta e jetësore. Ato na pasqyrojnë me vërtetësi psikologjinë e personazheve e dramën e jetës së tyre. Këta personazhe mbartin psikologjinë e mendësinë e kohës që jetojmë. Personazhet, as dhe njëherë nuk janë të sajuar, nuk janë të stisur e skematikë, janë njerëz të gjallë e realë me psikologjinë e jetën e tyre të veçantë. Për portretizimin e tyre , Ramiz Gjinin e ndihmon përvoja e e pasur jetësore, puna prej vitesh si gazetar dhe aftësia për të komunikuar me njerëz të të gjitha shtresave dhe profesioneve. Ai na i skalit këta personazhe me fytyrën e tyre plot jetë të brendshme e joshje, për t'u hetuar me karakterin e bëmat e tyre.

Ecuria e ngjarjeve dhe e veprimeve është e natyrshme dhe në varësi të psikologjisë e mendësisë që kanë. Për këtë arsye nuk na mërzisin, nuk na nxisin të kapërcejmë faqet e të hidhemi tek ndonjë rrëfim tjetër më interesant e më joshës. Ramiz Gjini nuk shkruan për të mbushur zbrasëtirën e kohës e për t'u marrë me një veprimtari intelektuale të vlerësuar nga shoqëria e rrethi i miqve të tij. Letërsia për të është një veprimtari pa të cilën jeta do t'i dukej e zbehtë dhe pa kuptim. Ramiz Gjini është një shkrimtar dhe tregimtar i lindur. Tegimet, romanet, përshtypjet e udhëtimit, artikujt publicistikë e gjithçka që ka shkruar, kanë lëngun e jetës, na sjellin pamje të gjera e të larmishme. Ky është tipari kryesor e më i rëndësishëm i këtyre tregimeve. Gjatë shtjellimit të subjektit vihet re fryma dramatike e lirizmi. Herë-herë ky dramacitet ndërthuret me sarkazmin e me ironinë. Personazhet herë-herë marrin ngarkesë humoristike e sarkastike. Por humori dhe sarkazma fsheh në brendësi dramën e hidhur të jetës.

2.

Tregimet e Ramiz Gjinit nuk janë si të prera me gërshërë dhe personazhet nuk janë kukulla e dordolecë në duart e një prestigjatori marramendës. Këta personazhe i ka lindur mjedisi e qarku ku veprojnë e jetojnë. Ata sjellin në tregime vërshimin e një jete e të një realiteti që ka veçantitë e kohës, të mjedisit e të mendësive me të cilën është mbrujtur personazhi. E gjithë kjo begati mendimesh, situatash, ngjarjesh, dramash e përplasje karakteresh na jepet me qartësi, me natyrshmëri, me vërtetësi e me një ndërthurje harmonike të dramës me poezinë.

Këta personazhe vërviten në një botë katoike plot shqetësime e përshtjellim. Jeta të shfaqet me fytyrën e saj të vërtetë: e pa pudrosur dhe e palyer me ngjyrime makijazhi. Ajo është e vërtetë, reale, me vështirësitë, pengesat, dramat, joshjet e magjitë e saj. Përgjithësisht e ngarkuar me drama e shqetësime. Personazheve u duhet të përballen me të panjohurën, me vështirësitë, me shtrëngesën ekonomike e me lloj-lloj vështirësish e telashesh. Si shkrimtar realist e me vështrim të mprehtë, Ramiz Gjini nuk e idealizon realitetim.

Në çdo kënd të botës dhe në vende mjaft të zhvilluara si Amerika, realiteti në tiparet e veta themelore ka të njëjtën pamje. Kudo është e pranishme lufta e njeriut për mbijetesë, lufta e njeriut me vetveten e me kurthet e prapaskenat e panumërta të jetës. Këtë të vërtetë universale na e zbulojnë mjaft tregime të kësaj përmbledhjeje. Tregimet "Frika", "Isaku, vëllaçkoja ynë i vogël", "Posta që sjell era", "Macja e zezë", "Ana Luigji", "Mërzia e thellë e vetmitarit Luis Medina", "Loja e humbur", "Ara e pakorrur", "Kthimi i dajës Alem" e të tjera si këto. Në tregimin "Kthimi i dajës Alem", Ramiz Gjini na jep faqe të reja nga jeta e dajë Alemit, personazh i ndeshur dhe në tregimet e para të autorit. Regimi duhej të merrte më shtrirje e të thellohej më në gjerësi e thellësi. Ai ka mbetur cakun e bërthamës së një novele, të pashtjelluar në të gjithë hapësirën e mundësitë. Jeta e dajës Alem ka pësuar në dukje një përthyerje me vajtjen e tij në një vend të madh jashtë shtetit. Të gjithë e dinin të mbytur në Danub, por ai kthehet pas 40 vjetësh me një makinë që të kujtonte të vdekurit, duke sjellë me vete gjashtë valixhe të gjata si gjashtë arkivolë. Që në penelatat e para, kuptohet se daja Alem nuk do të sillte gëzimin në katundin ku kishte lindur. Përveç këtyre gjashtë valixheve kobëtare e të çuditshme, ai s'kishte fituar asgjë nga jeta. Ishte munduar e rropatur më kot me ëndrrën se me punë e me kursime do ta ndryshonte jetën e do ta shporrte njëherë e përgjithmonë mjerimin e skamjen. Ai tani është i sëmurë, gëlltit tableta ilaçesh, është plakur dhe i është shuar fare drita e gëzimit. Mërgimi i gjatë larg katundit e të afërmve i dha vetëm këto valixhe si arkivole, por i mori rininë dhe s'e la të ngrinte një familje e të gëzonte. Në skicimin e dajës Alem, shkrimari ka përdorur ngjyrat dramatike e sarkastike. Daja Alem sa ç'është një personazh tragjik, aq është një dhe komik në në veprimet dhe ëndrrat e tij. Personazhet e tjerë edhe pse interesantë kanë mbetur të pashtjelluar sa duhet. Atyre u mgunon tipizmi e lënda e nevojshme, që do t'i bënte më konkretë e më jetësorë. Shkrimtari është shpejtuar dhe është mjaftuar vetëm me një skicim të përciptë.

3.

Duke qenë shkrimtar që në parimin e vet estetik ka pasqyrim realist e të pabojatisur të jetës e të personazheve, Ramiz Gjini na e shpalos jetën ashtu siç është në të vërtetë, me dritat e hijet e saj, me dhimbjet e dramat e panumërta e të dhimbshme. Përvoja e shkrimtarit dhe e gazetarit dhe kalimi i një fëmijërie të vështirë i ka mprehur shikimin dhe e shtyn të vërejë më në thellësi, pa rënë në pozitat e një nihilisti e të një shkrimtari dekadent që vështron vetëm anët e errëta të jetës, duke na krijuar përshtypjen se jeta njerëzore është një zgjendërr e frikshme, e ngarkuar me të papritura e me ankthe., përkundrazi vështrimi i Ramiz Gjinit është i kthjellët. Ai zbulon vlera shpirtërore tek personazhet, vlera që hedhin dritë mbi ngjarje tronditëse,mbi tablo të ngarkuara me dhimbje e dramacitet.

Herë-herë u kundërvihet të keqes e psikologjisë disfatiste të personazhit, siç ndodh në tregimin "Frika", "Isaku, vëllaçkoja ynë i vogël" apo "Ana Luigji". Këto tregime, dhe pse të përafërta nga optika e shikimit, na përcjellin mesazhe domethënëse filozofike, na pikturojnë anë të ndryshme të jetës. E rëndësishme në to nuk është ngjarja e as subjekti, por psikologjia e personazheve.

Tek tregimi "Frika", përmes ballafaqimeve tronditëse, autori fshikullon njeriun indiferent e frikacat, njeriun që mbyllet në guackën prej kërmilli edhe atëherë kur duhej të dilte nga kjo guackë. Në tregimin "Isaku, vëllaçkoja ynë i vogël", autori na rrëfen sesa e pakuptimtë dhe e mërzitshme bëhet jeta, kur njeriu i largohet luftës me vetë jetën. "Ne nuk kishim histori, nuk kishim të kaluar të virtytshme dhe as të ardhme. Ishimim dënuar të zhgërryeheshim në baltën e rrëshintë të një stine të ftohtë".

Tregimet e Ramiz Gjinit nuk janë shkruar sipas një skicimi të paramenduar e të hedhur në letër me saktësi pedante. Ato shquhen për befasinë, për të papriturat, për kthesat që marrin ngjarjet e për zgjidhjet krejt të natyrshme të situatave. Ramiz Gjini i qëndron besnik të vërtetës së jetës e të karaktereve. Është kjo e vërteta e kodi psikologjik i personazheve, ato që vendosin se si do të rrjedhë ecuria e rrëfimit e si duhet të përfundojë. Kjo natyrshmëri e vërtetësi që na jepen me korrektësi, me realizëm e përmes nj materiali të begatë jteësor, i bën tregimet të lexohen me këanqësi e të jenë joshës. Këto janë tregime psikologjike e dramatike. Ato nuk na kalojnë përpara syve pa u vënë re, pa na derdhur në shpirt ngarkesën e vet, shpessherë të dhimbshme e me drama njerëzore. Ramiz Gjini është shkrimtar që vështron në thellësi, shkrimtar që përpiqet të gjejë nënshtresat e realitetit të kohës së sotme, temat dhe problemet që e shqetësojnë vëmendjen e tij prej qytetari e shkrimtari. Ai nuk mban qëndrime soditëse e nuk i shmanget trajtimit të temës aktuale.

Këta personazhe janë njerëz që i ka ndeshur nëpër rrugëtime, në fshatrat e vendlindjes së tij apo në hotelet, bujtinat, rrugëve e stacioneve të trenave e të trojlebuzave të Nju Jorkut. Emrat, identiteti, psikologjia e mendësia e tyre, ashtu si dhe prejardhja e vendi nga kanë ardhur e janë takuar rastësisht me shkrimtarin janë të ndryshueshëm në situata të papritura dhe shpeshherë krejt rastësisht, ashtu siç na ndodh shpesh në jetë. Ata janë malësorë e fshatarë nga malet e fshatrave veriorë të Shqipërisë, mërgimtarë të kombësive të ndryshme apo amerikanë që banojnë në Nju Jork. Janë njerëz që merren me punët e bujqësisë, trafikantë apo nevojtarë, njerëz të vetmuar apo të goditur nga ndonjë fatkeqësi, njerëz që luftojnë e rropaten për t'i bërë ballë jetës. Dhe gjithnjë në kërkim të një jetese më të mirë, të një njeriu që do t'i kuptojë e do t'ua ndriste akullsinë e vetmisë: luftëtarë që kanë luftuar nëpër frontet e luftës në Vietnam apo Irak, që kanë marrë ndonjë cifël plumbi në rrethime e sulme në Falluxia apo Mosul. Lënda jetësore e pamjet e përfytyrimet që ato sjellin nëpër tregime, na krijojnë me realizëm e me saktësi pamjen e realitetit të sotëm dhe mjedisin e vendit ku ndodhin këo ngjarje e ku janë vërtitur e jetojnë këta personazhe. Ramiz Gjini di të përshkruajë, të na pikturojë peizazhe e mjedise, të skicojë e skalisë karaktere, të depërtojë në botën e tyre të brendshme për të na i paraqitur sa më konkretë e jetësorë, sa më të larmishëm e të besueshëm.

Gjatë viteve përvoja e shkrimtarit është psuaruar dhe pena e tij e frymëzuar është aftësuar për të qenë më e saktë, më sintetike, më befasuese e më jeteësore. Fraza dhe fjalia e tij është e natyrshme dhe e ndjerë. Në të rrallë të takon të gjesh veprime e situata artificiale, rënie në përskrime e mosgjetje të një filli të brendshëm filozofik e simbolik, që u jep këtyre tregimeve e przës së Ramiz Gjinit fizionominë e vet origjinale.

Janë në qarkullim nga shtëpia botuese "M&B"



Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-19-6
Çmimi: 700 lekë

Mund ti porosisni
me tel:
+ 355 4 2 233 283

Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-12-7
Çmimi: 1000 lekë





Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-14-1
Çmimi: 500 lekë

Mund ti porosisni
me email:
mbbotime@gmail.com

Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-13-4
Çmimi: 1200 lekë



Rruga Arbërit nr. 34
botime

"Libri vjen në një kohë kur të gjithë, shoqëria, historia, shkolla dhe proceset në Shqipëri i janë futur një reformimit të thellë në fushën e arsimimit, të edukimit atdhetar dhe të njohjes së historisë..."

Qëndrestarja Sibe



Skicë nga: Dejang NOVA

E kam njohur nënë Siben para dy vjetësh. Më ka mbetur në mendje. M'u duk se ishte e gdhendur në gur. Me një fytyrë të brazduar nga vitet e shumta që mbante mbi kurriz. Flokë të bardhë si qeleshe Korabi. Trupi i roitur, por gjithësesi i mbajtur. Buzëqeshje e çiltër. Dhe mbi të gjitha: sytë dhe zemra e saj.

Duart me gishta të gjatë, shputa gjithë vija, suprina gjithë damarë të mavijosur, duar që të shtrëngonin fort si të mos ishte gati shekullore.

Zëri, më shumë semitone, buronte nga zemra. I ngrohtë, i dhembshur, i dashur. Kumbonte mirësi, paqe, drejtësi, pastërti.

Fjalët, të mençura, hokatare, të qarta, jgjithë merak. Tregonte historinë e njeriut të vërtetë me shumë halle, vuajtje, sakrifica, qëndresë, pasqyrë e së cilës ishte gjithë qenia e saj.

Çdo fije floku e bardhë – një ngjarje. Çdo rrudhë e ballit dhe e faqeve një dhimbje e madhe. Çdo ofshamë – një dramë. E tëra një enciklopedi e hapur që fliste.

Nuk ndejta gjatë atë ditë. Djali i saj, xhaxhi Veri, rreth 70 vjeç i qëndronte afër dhe e shihte drejt e në sy dhe ia përpinte fjalët. Xhaxhi veri ka shkruar dhe një libër. E kam lexuar me një frymë. Më shumë se titulli që ka, mendoj se do të quhej poemë për nënën.

Për mua, por edhe për të tjerë, faqet për nënën janë të mrekullueshme. Më saktë:prej fillimit deri në fund nëna është prezente. Kur mbaron librin të duket se pe një copë shkëmbi nga Korabi, një kapitull nga Kanuni, një libër nga Nderi e dinjiteti, një volum poetik dashurie dhe malli, një kolonë të rëndë nga burëria dhe njerzillëku. Një simfoni e pambaruar.

Papritmas nënë Sibja u sëmur.

Shkova menjëherë. Ia mora dorën dhe ia shtrengova në gji. Ia fërkova kokën. E përqafova. E përshëndeta. Ma njohu zërin. Deja e Macukullit – tha- I shtëpisë së Vatë dedajve. Si je?!

- Mirë ! – tha

Ishte në krevat, po u ngrit. Me vështirësi. Nusja e nipit, Mirela, i tha të mos lëvizte, po ajo e shikoi pak egër dhe i tha

- A e di se kush ka ardh?

Dhe u dha udhëzime për drekën.

Kishte ardh dhe djali i dytë nga Neë-York, Irfani. Edhe vëllai i tij më i vogël, Kadriu.

Qëndroi stoike deri në fund. I kërkoj leje që të largohem dhe u përshëndet me mua me urime në gojë.

Diçka më sëmboi në zemër. Te dera mbajtur për shkopi me sytë e lodhur më shoqëroi deri sa kapërceva avllinë...

S'e pashë më. Në qershor marr vesh se ndrroi jetë. E përjetova me dhimbje të madhe. Shkova. I dhamë lamtumirën e fundit.

Kanë kaluar kohë. Takohem me xhaxhi Verin. Bie fjala për nënën. Nis e tregon: e thirra nga dera e madhe – o nënë, a je?

- Gjallë dhe e fortë.

Nxitoj, i hap derën ngadalë dhe i jap selamin. Nuk ma ktheu, as më shikoi drejt në sy si herët e tjera.

- Nënë a je mirë?

Ajo hesht. S'përgjigjet. I rrudh sytë si t'ia vriste një dritë e fortë dhe me dorën e djathtë bëri shenjë që t'i hiqesha syshë, se ia vriste ato. Ishte zemëruar. Kishte tre ditë që s'e kisha parë. Që s'ia kisha dëgjuar zërin, që s'e kisha përqafuar.ishte zemëruar keq. E ndjeva veten keq. Si të justifikohesha? T'i thosha se kam qenë i mbytur në punë, do të më thoshte: Pse të vish te nëna, s'është punë?

T'i thosha. Ti nënë je mirë dhe e fortë. Pret. Punët s'presin. Gjashtë fëmijë si gjashtë yje ndrisin rrugën nëpër pyje..., do të më thoshte: doktor, je ti, o Veri? Mirë dhe e fortë përherë do të rri unë? Ku shoqet e mia?

S'gjeta shteg tjetër:

- Mirela, oj nënë, pak sëmurë..e çova në Stamboll. U vonova.

- Për Mirelën ke bërë mirë! Mirela është vajza ime, më e mira! Po...tre ditë...shumë.

Mendova t'i bëja një zë fëmijërisë. Është një kopësht me pemë të pakudogjendura. Cilin frut të zgjedh, ta marr e t'ia sjell nënës? T'ia ëmbëlsoj gojën? T'ia vë dorën në ballë? T'ia fashoj zemrën?

E gjeta! Si "ketër" i vogël iu ula në prehër. Pa i rënduar koka ime i arriti poshtë buzëve të saj. Aroma ime e dehur. E ktheu vetëtimë 70 vite pas. Më pa si atëherë kur isha fëmijë që më mbante në gji e më këndonte këngë njëqind e një. Si atëherë kur ma lëmonte kokën e m'i thoshte mollë e ftua.

S'u gabova. I iku zemërimi. Rrudhat sikur iu zhdukën, flokët sikur iu nxinë, fjala gurgulloi si gurë: Lule, lule, nëna djalin!...

U pajtuam!

Jam në librin e xhaxhi Verit. Përfytyrimi e imagjinata ime punojnë me ritëm të lartë. Shpalosin të madhërishmen dhe të bukurën – Nënë Siben. Herë shoh nuse Siben me gëzimin e shqetësuar që do të bëhej nënë, herë kryefamiljaren që ishte edhe burrë, edhe grua, edhe babë, edhe Nënë, edhe mësuese, edhe prind. E shoh nënë Siben në të gjithë pozicionet e një gruaje model shqiptare.. dhe natyrshëm shkruaj për të:

Nënë Sibe, moj shqipe, tre djem se ç'i rrite, tre djem si rreze drite, e urta e pa qeta, e thjeshtë si e vërteta, Shpirtmadhe, moj Sojnike, ç'na ike pabesisht.

Vlerat luftarake të dibranëve në një libër

Nga: **Nënkol. Dr. BERNARD ZOTAJ**

"Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit dibran" është një libër i përgatitur enkas për studiuesit dibran, por dhe për të gjithë njerëzit e mirë dhe të dashur të kësaj treve dhe më gjerë. Ai është i përgatitur për botim nga veteranët e palodhur dhe të nderuar: Emin Agolli, Sali Hoxha, Xheladin Krifica, Pali Carapuli dhe Sefer Kosova. Libri shërben për njohjen e historisë së zonës së Dibrës në vitet 1939-1944 dhe pasqyron njohuri për lindjen, zhvillimin e përsosjen e veprimeve luftarake në këtë zonë, për luftë kundër pushtuesit nazi-fashist.

Ky libër është një histori që ka nisur nga viti 1968, për pasqyrimin e të gjithë veprimtarive dhe aksioneve të njësiteve, çetave dhe formacioneve luftarake që vepruan në vitet e LANÇ. Është shkruyar e diskutuar gjerësisht që nga viti 1969, ku kanë marrë pjesë gjithë ishpartizanët, vullnetarët, miqtë dhe simpatizantët e Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare në këtë qark. Libri është mbështetur në maketin, në vrejtjet dhe propozimet të cilat janë pasqyruar gjerësisht. Ndihmesë kanë dhënë Ahmet Jegeni, Qazim Prishtina dhe Hilmi Çaushllari, si dhe në mënyrë të veçantë mendimet, këshillat dhe dokumentet e Haxhi Lleshit, të Haki Stërmillit të cilët ka lenë shumë gjurmë patriotike në këtë zonë të lavdishme.

Libri përbëhet nga pesë krerë.

Në **Kreun e Parë** prezantohen Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit dibran. Aty përshkruhet gjendja e krahisës së Dibrës para fillimit të Lëvizjes Antifashsite Nacionalçliorimtare.

Në **Kreun e Dytë** shkruhet për punën e PKSH dhe veprimet luftarake të formacioneve partizane në Dibër, fillimi i veprimeve luftarake, aksioni te Gurët e Skënderbeut (Bulqizë), prereja e linjave telefonike, përpjekja në Urën e Topojanit, aksioni në minerën e Bulqizës, vrasaja e një spiuni të rrezikshëm, ndjekja e çetës nga forcat armike, aksioni në rrugën Dibër-Strugë, djegja e Martaneshit, çeta e Dibrës në Mat, ngjarjet në Okshtimë, pranimet në parti, shpërndaraja e të dhjetave, aksioni i 7 prillit 1943, aksioni i Hanit të Trebishit, aksioni i Martaneshit, formimi i batalionit partizan të Dibrës, çlirimi i Zerqanit, lufta e Maqellarës, lufta e Sofraçanit, kapitullimi i italisë fashiste, hyrja e forcave partizane në Peshkopi e Dibër të Madhe, Lufta e Dytë e Dibrës së Madhe, tërheqja e forcave partizane nga Dibra e Madhe, operacioni armik i dimrit 1043-1944, kalimi i Divizionit të I S në veri dhe çlirimi i plotë i Dibrës, çlirimi i parë i Peshkopisë më 6 korrik 1944 dhe formimi i Brigadës së 18-të Sulmuese.

Kreun i Tretë trajton veprimtarinë e krerëve reaksionarë dhe të organizatave tradhëtare në Dibër.

Kreun i Katërt u kushtohet problemeve të vendosjes së pushtetit të Këshillave Nacionalçlirimtare.

Ndërsa në **Kreun e Pestë** trajtohet gjerësisht ndihma internacionaliste e PKSH-së dhënë popujve shqiptarë e maqedonas në Dibër-Gostivar-Kërçovë-Tetovë dhe Strugë në luftën kundër nazi-fashismit.


Libri përmban një material të pasur e me dokumente nga fusha e historisë ushtarake në këtë periudhë e cila është tepër e plotë dhe e pasur me materiale dokumentare.

Libri ka mjaft vlera sepse bazohet në propogandistët e kësaj periudhe dhe në shkrimet e në veprimtarinë e tyre gjatë kësaj periudhe për të cilën ata shkruajnë e pasqyrojnë këto ndodhi dhe ngjarje të zhvilluara në atë kohë.

Ndaj dhe mendoj se libri është një bazë e mirë për të gjithë studiuesit ushtakë dhe letrarë për të pasqyruar këtë periudhë të lavdishme të këtyre formacioneve luftarake.

Në libër përfshihen mjaft tematika, ku trajtohen drejt dhe saktë parime të artit ushtarak, koncepte, norma, teknika luftarake, armatimet si dhe përvoja duke u nisur nga më e thjeshta e deri në më të ndërlikuarat në fushën e luftimit dhe në betejat ushtarake, në periudha të ndryshme e të rëndësishme të zhvilluara në këtë kohë të lavdishme.

Këtij trajtimi profesional i ka shërbyer shfrytëzimi



dhe përdorimi i mjaft materialeve të kohës, të pasur, të botuar, të autorëve të tij në shumë vite pas këtyre ngjarjeve.

Theksoj se autorët i'a kanë dalë, për të dhënë një libër të domosdoshëm dhe të kohës për këtë epope që sot ka shumë hamëndje dhe mendime nga më të ndryshme për këtë luftë dhe këtë veprimtari patriotike dhe atdhetare.

Libri trajton në mënyrë të detajuar dukuri e veçori të artit ushtarak të kësaj treve, të spikatura në disa luftime e beteja që u përmbahen periudhave të këtyre viteve në këtë zonë tepër luftarake dhe atdhetare.

Në libër jepen përgjithësime dhe përfundime që lidhen logjikisht me një varg dukurish për organizimin e luftimeve, për taktikën, artin ushtarak, teknikën luftarake dhe të armatimit, nga njëra periudhë e zhvillimit në një tjetër, nga një armik, në një tjetër.

Stili dhe gjuha e përdorur nga autorët përcjellin thjeshtë e qartë mendimet, artin, konceptet dhe parimet e kësaj lufte, si dhe bëjnë një shtjellim të plotë të veprimtarisë luftarake. Kjo e bën librin tepër të thjeshtë, të kuptueshëm, si dhe tërheqës për çdo lexues që ka interes për të njohur historinë, por dhe më gjerë.

Duke e vlerësuar nga tmatika e gjerë e paraqitur në këtë punim, mendoj se libri i paraqitur vjen në kohë e duhur dhe është i vlefshëm dhe i bën nder çdo dibrani, por dhe më gjerë.

Shpreh mendimin se ky libër përbën dhe një risi të veçantë e objekt të dyfishtë, si: pasqyrim të kësaj periudhe për një njohje të gjerë, por dhe si libër i mirëfilltë për njerëz, ngjarje, patriot dhe veprime luftarake në këtë kohë të lavdishme të historisë sonë të përbashkët.

Nisma e autorëve për një punim të tillë, për t'u dhënë njerëzve të thjeshtë një përvojë, një traditë e një veprimtari të kryer 65 vjet më parë përbën një dukuri të re, e që gjykoj se duhet pasuar nga punime e botime të mëtejshme për këto probleme luftarake por dhe të periudhave të ndryshme të qarkut të Dibrës.

Libri vjen në një kohë kur të gjithë, shoqëria, historia, shkolla dhe proceset në Shqipëri i janë futur një reformimit të thellë në fushën e arsimimit, të edukimit atdhetar dhe të njohjes së historisë ashtu siç është zhvilluar dhe të bërë publike nga ata që e kanë bërë këtë veprimtari.

Në librin e paraqitur, vlerësoj seriozitetin profesional të autorëve, për të paraqitur një punim me vlera dhe nivel të lartë të problemeve të historisë luftarake, i cili do t'u shërbejë edukimit dhe formimit të njerëzve të qarkut të Dibrës, por dhe për më gjerë.

** Autori është Shef i Seksionit të Historisë Ushtarake në Akademinë e Mbrojtjes "Spiro Moisiu"*

"Ky libër shqipton shumë çështje dhe shtjellon shumë argumente që në studimet shqiptare nuk janë trajtuar thuajse asfare më parë"

SHEMBËLLTYRA SI LIGJËRIM PARATHËNËS

Nga: **SHABAN SINANI**

Libri "Shembëlltyra në folklor dhe letërsi" i Hajri Mandrit është shkruar fillimisht si tezë për shkallën "master", me titull pune "Shembëlltyra në tregimet alegorike dibrane".

Duke e rilexuar tashmë si një monografi që u drejtohet studiuesve, lexuesve me interesa në fushë të letërsisë, folklorit, etnografisë, ligjërimeve gjuhësore, jo thjesht për ta paraqitur me dinjitet para një komisioni specialistësh, vlerat e këtij libri mund të çmohen në një kontekst më të gjerë.


Shembëlltyra është art dhe atribut i parathënësve. Profetët flasin me shembëlltyra. Në paremiologjinë hebraike kjo mënyrë e kushtëzimit të fatit të jetës njerëzore prej shembëlltyrës profetike shprehet me fjalën e urtë "E ardhmja juaj është e shkruar në të shkuarën" - "Your future is in the past".

Në shkrimet e shenjta, gjithçka që ndodh në këtë botë ndodh sepse një shembëlltyrë e ka paralajmëruar. Për të argumentuar ardhjen e "lajmit të mirë" (gr. "Euangelion") dhe të profetit të tij, Krishtit në tekstet ungjillore thuhet thjesht se kjo ndodhi "sepse Moisiu u tha etërve "se Zoti Perëndia do të ngrerë ndër ju nga vëllezërit tuaj një profet si unë; atë dëgjoni për të gjitha ato që t'ju flasë" (Vep. Ap. 3: 22).

Libri i Hajri Mandrit (M. A.) e mori pikënisjen pikërisht nga kjo formë ligjërimi e moçme sa vetë bota, që ka mbijetuar nëpër kohëra jo vetëm si ligjërim liturgjik dhe predikues, por edhe si ligjërim folklorik, etnografik, etno-juridik, duke ruajtur shumë cilësi e funksione të kryehershme. Ai i vuri vetes si detyrë qysh në krye që përmes gjedheve dhe modeleve zanafillorë, sikurse janë ato biblikë, mitologjikë, kur'an-orë, të identifikojë shembëlltyrën si figurshmëri poetike në folklor e në letërsi, kushtëzimin e shembëlltyrës laike prej asaj teologjike e teozofike (më së shumti mistike), fuqinë e saj estetike, morale, juridike e psikologjike.

Kjo ishte një punë fort e vështirë, sepse të merresh me shembëlltyrën, me burimin e saj, me të folurit parathënës (profetik) në përgjithësi, do të thotë të merresh jo vetëm me një çështje filologjike ndërdisiplinore, por edhe me atë që zakonisht quhet "hermeneutica sacra", sot një nëndisiplinë e teorisë së përkthimit, që merret me interpretimin e teksteve kanonikë; me të fshehtat shumëkuptimshe që përmbajnë shembëlltyrat profetike dhe me ndikimin e tyre në mendësinë e njeriut përgjatë rrjedhave të kohërave. Në një farë mënyre kjo do të thoshte të kërkoheshin e të studioheshin edhe ato rrethana të ndërlikuara parahistorike e historike, në të cilën njeriu vdekëtar i kohërave të mugëta i dha kompetencë mendjes së vet të përdorë modele ligjërimi si të profetëve, duke dëshmuar një lidhje shumë të hershme të kësaj tradite me burimin parësor, lidhje që në të drejtën etnozakonore shqiptare shprehet, ndër të tjera, edhe me "derën e hapur të konakut", sepse nuk dihet kush troket në derë: "profeti apo përderësi" - kohë që më së voni përtakon me fillimet e krishtërimit, me krishtërimin apostolik, kur dëshmitarët e profetëve ishin pjesë e bashkësisë (gr. "ecclesia"), që më vonë do të shenjonte faltoren.

Pavarësisht se shembëlltyra terminologjikisht përmendet kryesisht prej kohës së kodifikimit të ungjijve, të folurit me shembëlltyra sundon gjerësisht gjithë traditën klasike mitologjike botërore, duke përfshirë ato të popu-



Në librin "Shembëlltyra në folklor dhe letërsi" lexuesi do të gjejë jo vetëm një lëndë të pasur burimore, fatmirësisht të mbledhur prej amatorëve të folklorit; jo vetëm trajtime terminologjike gjuhësore dhe letrare për shembëlltyrën në ligjërimin gjuhësor, folklorik e letrar; jo vetëm argumente për mundësinë e një tradite vendëse të kryehershme të përdorimit të saj dhe të drejtimeve të ardhjes së ndikimeve, por edhe analiza të funksioneve të kësaj figure dhe mënyre të kumtuari, që janë shtresë-mbi-shtresë të vendosura nga një kohë në tjetrën.

jve fqinjë, të grekëve dhe latinëve. Me shembëlltyra flasin orakujt, me shembëlltyra flet edhe sfinksi, gjë-a-gjëzat e të cilit janë rebuse shumëkuptimësh. Olimpi i lashtë helen kishte dhe një hyjni me atributin e përkthimit (në të vërtetë të mosmarrëveshjes dhe të moskuptimit): Hermesin, prej nga ka ardhur edhe emri i shkencës "hermeneutikë" dhe idioma "shprehje hermetike", domethënë e pakuptueshme.

Deri në dorëshkrimet ungjillore të periudhës para "dekretit të së dielës", madje dhe më vonë, emri i Perëndisë (hebr.: Adonai, Elohim) as përkthehet, as transliterohet, por ruhet sekret dhe shenjohet si në aramaisht, me tetragramin e mirënjohur ose me simbole të fshehta, si peshku, pëllumbi, pastori (bariu i grigjës), sepse ishte tabu. Mjaftonte shembëllimi për të mbërritur intuitivisht tek thelbi. Mjaftonte shenja për të shkuar te e vërteta.

Mitologjitë dhe librat e shenjtë e kanë pasur të fshehtën një mënyrë komunikimi të hyjnive me njerëzinë. Hyjnitë antike ishin shumë xheloze ndaj atributit që vetëm atyre u takonte. Kur Kasandra paratha se çfarë e priste Trojën nëse do të pranohej kali i çuditshëm i Odiseut, jo me ndonjë shembëlltyrë, por me të folurit e njerëzve vdekëtarë, hyjnitë e dënuan me mosbesimin e përgjithshëm qesëndisës të gjindjes. Magët (distarët) persë dhe mobedët zoroastrianë gjithashtu flisnin me shembëlltyra, ca sepse i tremben pushtetit të shahëve dhe ca sepse kështu ka qenë dhe është stili i ligjërimit të tyre. Nëse nuk ka shembëlltyrë, s'ka mësim prej së shkuarës, s'ka as kështillë për sovranë dhe as për agoranë.

Tradita folklorike shqiptare, sidomos ajo e rajoneve më pak të hapura ndaj kulturave të shkruara, sikurse është Dibra, Luma, një pjesë e madhe e Kosovës, që u bë objekt i studimit të autorit Hajri Mandri, ruan shenja të shpërfaqura të kulturës së një populli, të parët e të cilit kishin arritur me kohë t'i zbritnin hyjnitë nga qielli në Olimp dhe mundoheshin t'i nyjëtonin mendimet e tyre në të njëjtin stil të lartë parathënës si hyjnitë. Ky stil ligjërimi nuk është studiuar ende jo vetëm në anën folklorike-letrare dhe estetike-etike, por as si një prej stileve të ligjërimit gjuhësor, si një prej formave të komunikimit të së shkuarës me të sotmen dhe të ardhmen.

Studimi i Hajri Mandrit, për qëllimin që u hartua, mund të mjaftohej edhe vetëm me një paraqitje panoramike-anatomike të formave të ligjërimit me shembëlltyra në tregimet alegorike dibrane, në të folurit me rrotulla të Kosovës, në kallzimet popullore të viseve të tjera veriore të Shqipërisë, që përbëjnë dukuri folklorike me përhapje tejet të gjerë deri në ditët e sotme. Një përpjekje për të shtresëzuar gjurmët e kohërave dhe ndikimeve në të folurit me shembëlltyra të këtyre rajoneve, mbijetoja të gjendjeve gjuhësore dhe të mendësive të epokave dhe botëve të prekura përgjatë procesit historik do të ishte vlerë shtesë e punimit. Por autori mund të mjaftohej gjithashtu vetëm me koleksionin e kanuneve, çdo nen i të cilëve në burim ka një shembëlltyrë, një kushtëzim i së tashmes që vjen prej së shkuarës, dhe kjo shpjegon karakterin konservator të tyre. Ligjërimi etnografik, i kodifikuar me të njëjtën vetëdije si dhe shkrimet e shenjta, ishte një objekt i vetëmjaftueshëm për të studiuar shembëlltyrën. Do të mjaftonte vetëm veçimi i asaj dukurie gjuhësore-letrare që autori me të drejtë e ka quajtur "e tashmja dëftore-urdhërore" apo "e ardhmja urdhërore", që cilëson ligjërimin etno-juridik: "Kush të vjedhë gjânë e gjallë të kishës, më rreth kû pershîn Kanûni, ká me lá dý per nji, si gjithkuej"; "Kush të vjedhë në qelë a bâne të Famullitarit, do të lajë dý per nji gjân e vjedhne, 100 grosh kishës per nderë të mârrme, e 100 desh e 1 ká giobë bajrakut"; "Aj, qi s'i vêhet ndeshkimit të kishës e të Kanûnit, bajraku do të mblidhet tok te shpija e tij e do t'i mârrë gjithshka të két në vathë" ("Kanuni i Lekë Dukagjinit", 1933, kreu I, nyje 8), për të përmendur vetë disa shembuj, në të cilën urdhëri nuk vjen nga forma gjuhësore, por nga stili i ligjërimit. Mirëpo autori e ka parë më me vend një rrugë tjetër, më të vështirë: të udhëtojë gjerë e gjatë në lëndën e pafundme folklorike dhe letrare, për të shpallur së pari fuqinë e shembëlltyrës në ligjërimet tradicionale shqip dhe për t'i hapur udhë vetes dhe studiuesve të tjerë, që në një të ardhme të ndërmerren kërkime të një karakteri tjetër, jo kaq të paskajuara, sikurse janë përgjithësisht studimet me karakter paraprirës. Ndoshta lexuesit as që i ka shkuar në mendje se shembëlltyra ka kaq shumë pushtet etnografik, ligjërimor-gjuhësor, letrar, didaktik, formues e informues, deri tek të dhënit e së drejtës, jo vetëm në shkallë të kodifikuara të komunikimit midis njerëzve, si odat e pleqnarëve dhe kuvendet e kryeparëve, por edhe në jetën e përditshme, në mënyrën si përshëndeten dy kalimtarë në rrugë apo si këmbejnë duhan, në mënyrën si pritet miku, si nis një bisedë e zakonshme në vatrën e të zotit të shtëpisë, në ditë të zakonshme e në të kremte të rëndësishme, në kishë a në xhami, në dasmë e në derte, në luftë e në paqe.

Autori ka zgjedhur procedimin më të dobishëm për lexuesin, me qëllim që ky libër t'i shërbejë atij si një udhërrëfyes për të hyrë me lehtësi në botën e ligjërimit me shembëlltyra. Sigurisht, si çdo udhërrëfyes, edhe ky nuk mund të ofrojë kode të gatshme për të kuptuar e shijuar të folurit me shembëlltyra, aq më pak për të përdorur vetë shembëlltyrën, sepse kjo mësohet bashkë me gjuhën, para se njeriu të bëhet për shkollë. Autori ia ka arritur qëllimit të bëjë përkufizimin e dukurisë, të bëjë të njohur gjendjen e saj në ligjërimet e sotme, format më të përhapura të shembëlltyrës laike sot, sa është ajo vendëse dhe nga kanë ardhur ndikimet e mundshme, në cilët shkrimtarë shembëlltyra ka më shumë peshë dhe rëndësi letrare dhe krijuese.

Në librin "Shembëlltyra në folklor dhe letërsi" lexuesi do të gjejë jo vetëm një lëndë të pasur burimore, fatmirësisht të mbledhur prej amatorëve të folklorit; jo vetëm trajtime terminologjike gjuhësore dhe letrare për shembëlltyrën në ligjërimin gjuhësor, folklorik e letrar; jo vetëm argumente për mundësinë e një tradite vendëse të kryehershme të përdorimit të saj dhe të drejtimeve të ardhjes së ndikimeve, por edhe analiza të funksioneve të kësaj figure dhe mënyre të kumtuari, që janë shtresë-mbi-shtresë të vendosura nga një kohë në tjetrën. Me shumë interes është renditja e argumenteve që shembëlltyra, përveç ligjërimeve liturgjike, përveç arketipeve mitologjikë, është ndikuar edhe prej letërsisë klasike perse, një pjesë e së cilës përmban të njëjtin kod kumtimi si dhe librat e shenjtë të besimeve abrahamike. Jo rastësisht libri i mirënjohur i Mevlana Xhelaledin Rumiut "Masnavi Maanavi" është mbiquajtur edhe "Farsi Qouran", "Kur'an-i pers". Ashtu si masnavitë e Rumiut, edhe vjershat e rrëfenjat e Saadiut janë polisemantike, për shkak të fuqisë së shembëlltyrës, mbi bazën e së cilës janë ndërtuar. Me rastin e poezisë perse dhe të raporteve të saj me librat e shenjtë sa i takon mbështetjes së njëjtë në të folurit me shembëlltyra është e ngjashme tradita shqiptare e ligjërimeve me shembëlltyra.

Ky libër shqipton shumë çështje dhe shtjellon shumë argumente që në studimet shqiptare nuk janë trajtuar thuajse asfare më parë. Autori u ofron nxënësve e studentëve njohuri parësore për një dukuri të pastudiuar, vetë bartësve të fundmë të ligjërimit me shembëlltyra një mënyrë të interpretuari të stilit të tyre të të folurit, specialistëve të letërsisë e të folklorit një varg problemesh të nevojshme për të gjykuar drejt mbi gjuhën, folklorin, letërsinë dhe marrëdhëniet midis tyre dhe mbi teoritë e evolucionit të zhanreve dhe të figuracionit; studiuesve të një niveli më të lartë formimi tema të hapura që presin njerëz të zellshëm dhe të formuar për t'u shpënë më tej. Duke e pasë njohur përmbajtjen e tij në formën që iu paraqit një komisioni specialistësh për vlerësim për shkallën e kualifikimit si master dhe në gjendjen që i paraqitet sot lexuesit mund të më lejohet të pohoj se ky proces diskutimi me specialistë të fushës, vetë mbrojtja para komisionit, i kanë dhënë monografisë një surplus intelektual.

"- Jepni dorën njëni- tjetrit, e mos mbani mëni, dashunia nuk njeh fe e ligje... Ajo asht vetë Perëndia, fytyra e tij. "



Nga:
BAJRAM HYSENI

Tërfili me katër fletë

"Tërfoja me katër fletë
Mjeri unë kush e ka gjetë
Medet se ç'u bë tërfoja.
M'a kërkon nuse zoja... "
Popullore

Familjet e Gjokolës e të Bitrit, edhe pse nuk janë të një besimi, hyjnë e dalin e i ndodhen njëni tjetrit pranë në hidhnime e gëzime. Ded Gjakola ka vetëm nji vajzë, Mrikën, kurse Staf Bitri, vetëm nji vlla, Sufën e nanën. Sufa e Mrika, u rritën bashkë, tue ruejt gjanë. Vetëm kohët e fundit, ata nuk shkojshin në mal. Sufa i mbushi njëzetëdy vjetët, kurse Mrika pesëmbëdhjetë. Ded Gjokola e ndaloi të bijën të shkojë me kullota gjanë. Vajza, vitin e fundit, lëshoi shtat e u ba kuq-kuq në fytyrë, si molla dhe gjinjët i brofën përpjetë e gjoksi ju fry sikur do ti plaste. Por ky vendim i Dedës nuk e gëzoi Sufën. Ai i mjerë, pesë vjet me radhë, andrroj për Mrikën, po kurrë nuk e pruni fati mbarë që t'ja thotë nji gjysëm fjale për dashurinë që e kish zanë. Shpesh kishte marrë vendim, po sa e shikonte Mrikën, i lidhesh fjala në grykë e në fytyrë këndellesh si llatuk gjeli dhe e shifte veten krejt i pazoti me qit fjalë prej goje. Tash që Mrika u ndalue të shkojë në mal, kjo u ba edhe ma e vështirë, sepse Mrikën e takonte vetëm oborreve, ku edhe muret baheshin hafie po të thoshte një fjalë. Shpesh e priste Mrikën në udhë, por pa dobi. Sufa e përshëndeste dhe ajo i përgjigjesh me nji buzëqeshje kokëulun e nji të kuq që i mbulonte fytyrën si duvak dhe asgja tjetër. " Edhe ajo e ka mizën në ksulë", - kishte mendue shpesh Sufa ndër vehte. Kohët e fundit, ai nuk flinte fare, vetëm mendonte, andrronte për Mrikën, për jetën. Si do të shkojë halli, "vetëm nji zot e dinte". Veç të tjerave, ajo asht edhe e krishtenë, "punë që nuk bahet". O Zot, pse kto vajzat e krishtena i ke ba ma të hieshme? – mendonte shpesh Sufa e folte me vedi. Në fytyrë i ra nji ngjyrë e verdhë dhe u ligështue shumë. Vetëm sytë i xixëllojshin si shkëndia, ndën nji vetull si gajtan i zi. Kishte sy të trishtueshëm, por edhe të zjarrtë e plot jetë.

-Pse je ligë kaq fort, bre Sufë?- i tha atij nji ditë nji shoku i tij teksa po ktheheshin nga stanet.

-As vetë se di, po e kam diçka më duket se zemrën s'e kam mirë. Edhe nana ma ka thanë këtë fjalë.

-Pa thueje, se do Perëndia e të ndihmoj edhe unë. Na shokë jemi. Pra më fol me zemër të çilun.

Sufa ktheu kryet me të shpejt, e shikoi shokun drejt në sy, mandej i foli me gjysëm zani:

-Mos më tradhëtoni !Selim! Të lutëm! Më dalç si vlla në këtë dhe n'at botë.

- Mos e thuej atë fjalë, por fol pa frikë, unë jam shoku yt i besës. .

- Kam sevda me nji vajzë, nuk flejë, po çmendem!

-Po me cilën?- Ja priti Selimi e sytë ja kishte ngjitë në fytyrë.

- Ma mirë mos ta thom emnin e saj, se nuk ka me të ardhun mirë. Le të vuej kështu si jam, Selim! Le të vuej, le ta mbaj ndry në zemër. . ! Mos të baft vaki si mue.

-Për kryet e nanës e gjithçka kam në shtëpi, as nuk e flas, as nuk zemrohem në ty, do ta ruej në zemër, sikur s'kam ndie gja! besa besë!

-Mrikën e Ded Gjolokës!- ja priti Sufa. - teksa zemra po i rrifte me të madhe. Ajo po më çon në vorr për së gjalli, më beso ! Edhe zgjuet, edhe në andërr, vetëm Mrikën kam para syve! Ma ka vjedhë zemrën si me magji... !

-Në Mrikën ke shtie sevda? Mjeri unë për ty por ajo është e krishtenë! Si kështu?

-Krishti vetë le të jetë, ta thashë, po mbaroj, në më ndihmon, mirë, në s'më ndihmon, mshile gojën e asgja tjetër, na shokë e vllazën jena prapë.

-Zor e ke, por po të tregoj nji ilaç. Gjej nji tërfojë me katër fletë dhe e fitove davanë, asht gja e sigurtë, e kanë provue shumë njerëz. Po ta gjej unë, kam me ta dhanë. Pra, unë edhe ti, asht mirë ta kërkojmë nji tërfojë ksi soji.

- Me të vërtetë ! Oh, ty të lumtë goja, ma grofe zemrën që më ishte ba akull.

-Për zotin, nji shok kështu e fitoi. Ja shtiu fletën e tërfojës në xhep e vajza ju qep prapa e i shkoi drejt e në shtëpi. E ç'vajzë, ma e mira në malet tona!...

... Atë natë, Suf Bitri nuk bani gjumë fare, tue mendue në asht apo jo e vërtetë përralla e tërfojës me katër fletë. Në mëngjes e zgjoi i vëllai e i ngarkoi nji detyrë:

-Ti, Sufë, do të shkojsh në Zall e të kositësh livadhin se asht pjekë tërfoja e mandej shkundet. Zakovat merri të ngushta, se ka bar shumë e drue të dhamin shpatullat, digjove?

- Si jo, do ta kositi me gjith qejf, që të mos kesh marak fare. Si mprefi kosën, e vuni në krah, Sufa u nis për në Zall. Rrugës ja kishte marrë fishkëllimës e ecte tue u shatapat përmes rrugës, ndonëse mendimin e kishte te Mrika, te ajo që e kishte në sy, në zemër, si ta kishte vjedhë prej pasqyrës. Drini rrëshqiste ngadalë i çkujdesun e degët e shelgjeve ishin varë e cekshin në ujë. Hieja e tyne dridhesh si gjarpën nga valët që shkojshin njëra pas tjetrës. Zogjtë cicërojshin nga vapa, e era e tërfilit të livadhit të mbushte krahnorin. Dielli i nxehtë të përvëlonte! Si kapërceu gardhin, Sufa ra në livadh, bari i erdhi deri në gju. Tërfoja ishte mbreti i livadhit të tij, i shtruem si qylym i blertë, cep e më cep livadhit. Përtej Drinit, në zall, ja thonte nji fyell bariu, kurse te gurra mrizojshin tufat e katundit.

-Këtu ka, jo me katër fletë, por edhe me tetë!- tha Sufa gëzueshëm dhe si vuni kosën në gardh u krrus të kërkojë tërfojën me katër fletë. Hap pas hapi, ai po afrohesh midis të livadhit. Prapa i mbeteshin gjurmët si në borë. Si u lodh tue ndejnë i krrusëm, u ngrit dhe vuni duert në ijë, u përkul majtas e djathtas e përsëri nisi punën për të gjetur fletën që do t'i epte lumtuninë. Ndoshta do të gdhihej tuj kërkue... Po zani i të vllait, nga maja e kodrës: "Eja në shtëpi!", sikur e zgjoj nga nji gjumë i randë, nga nji andërr, sa e mirë, aq edhe e trishtë.

-Bobo, iku dita, për zotin ! – tha me vete, mandej ai e fshehi kosën në shelgjet që rrethojnë livadhin e u nis për në shtëpi.

-Nanë, nuk më hahet darkë, due me fjetë, jam lodhshëm! – i tha Sufa namës, por Stafa e ndigjoi e si bani buzën në gaz i foli:

-Eh ti, pizeveng, u lodhe me dhjetë zakovë, eh, ç'burrë na qënke...

-Jo dhjetë, po gjysmën e livadhit, ja priti Sufa krenarisht. Nesër shpresoj ta mbaroj krejt, - tha me vendosmëni, sikur me të vërtetë do të kishte krye aq punë, si një burrë bash kostar.

-Të lumtë, për ty kena me gjetë nji nuse, ma të mirën në këto anë. Më ka thënë nji mik se përtej Drinit, asht nji cucë, që shoqe nuk ka, ke del e ke bie Drini në det. Nesër do të shkoj në bjeshkë për furda dhe me t'u kthye, do të çoj njeriun ta kërkojë cucën. Kena me ba dasëm të madhe e do të grishim gjithë miqtë e shtëpisë sonë. Sufa e pa të vllanë në sy dhe buka iu lidh në grykë si sukull po nga turpi, se ishte nana aty, nuk tha asnji fjalë. Ndërsa me mend e veta tha: "Kurrë mos u baftë e mbarë, unë do marr Mrikën". Në mëngjes, si u përshëndet me vëllanë, Sufa u nis për të mbarue pjesën që kishte mbetë në livadh. Edhe kjo ditë shkoi si të tjerat, tue kërkue tërfojë me katër fletë, po qe e kotë. Ai e kërkoi livadhin cep më cep e tërfoja s'po gjindesh. - Edhe kjo s'asht gja!-tha me vehte Sufa, - Duhet zemër, zemër, me katër fletë. Eh, moj Mrikë, ç'po më mundon, borxh do të më jesh, në këtë dhe në atë botë!... Të nesërmen, që ishte dita e tretë, nanë Fatimja, ra të shofë kostarin. Kur u afrue pranë gardhit pa se i biri ishte krrusun në mes të livadhit, sikur kishte humbë gjylpanën.

-Ç'farë ban kështu, more kostar i nanës? Kështu e ke kosit livadhin? Po nusen si do ta ruejsh, kështu tue bredh pas flutrave?. . Sufa ktheu kryet i trembun e mandej erdhi me vrap te nana e vet.

-Nanë, mos u mërzit, unë ndiha shokët e mi e ata do më ndihin nesër. "Edhe unë nuse po kërkoj, - tha me vehte, - por s'po e gjej!..."

- Mirë, pra, hajde shkojmë në shtëpi. - Dhe të dy, nanëe bir, pranë e pranë, tue kuvendue, u nisën për në shtëpi. Në fund të rrugës takuen Mrikën e Ded Gjokolës, me bucelë në shpinë e kokëulun, shpejtonte hapin për të ra rreth Drinit.

-Ku shkon, moj Mrikë!-tha nanë Fatimja, asht vonë. -Ka ra hieja në Dri.

- Due me mbush bucelën. Vllaut i ka ra në mend me vra nji bletë për pashkët. Na ka ardhë edhe nji mik i shtëpisë sonë e duam me gostitë me mjaltë.

-Oh sa mirë, por. . Mos u tut, po të jap Sufën me të ruejt. Mandej nana iu drejtue të birit: -Dëgjo, Sufë, rri këtu fund udhës e prite Mrikën e unë po shkoj të mjel lopën. Dedës po i thom se asht Sufa rreth Drinit e të mos ketë merak për Mrikën. Hajt, pra, të pastë nana, - dhe u nis për në shtëpi.

Sufa gati sa nuk iu hodh në qafë nanës e ta puthë nga gëzimi.

"Sa e mirë asht nana e jeme!... " - mendoi ai me vehte. O Zot! Duket po më ndih edhe ti, që e sjell kaq mbarë... Sonte qoftë natë e mirë dhe mbarë, se kam me ja thanë copë. Mendoi Sufa!

-Ma mirë po bije me ty deri rreth Drinit, moj Mrikë!- tha Sufa.

-Si të duesh, or Sufë!- ia ktheu Mrika, pa ja lëshue sytë, por me za të plotë. Zhurin e kaluen pa ba za. Kur ranë rreth Drinit, Mrika e hoqi tërkuzën qafe dhe e lëshoi bucelën në ranë e mandej nisi ta mbushë. Ujët binte në bucelë me zhurmë. Sufa lëshoi disa gurë n'ujë tue luejt e mandej i tha Mrikës me gjysëm zani:

-Mrikë!...

Ajo ktheu kryet me të shpejtë dhe e pa drejt e në sy. Shikim si ky Sufa kurrë nuk kishte pa. Dy sytë e Mrikës e therën si shigjeta.

-Ç'ka don?

- A ke gjetë ndonjiherë tërfojë me katër fletë?

- Ç'ka më duhet? Nuk e kam kërkue se edhe mund ta gjej, livadhet e fushat tona janë plot.

-Eh se sa kushton! Pa gjeje, pa ta shofish se sa kushton. Ajo nuk blehet me pare. Edhe trojet janë ma të lira se ajo...

-Kush ta ka thanë?

-Nji shoku jem.

-Mos e beso, s'asht gja. Edhe unë kam pas ndie gjyshen, që folte për tërfojën me katër fletë. Janë përralla, or Sufë... Nuk ka tërfojë me katër fletë, qiell e tokë të bashkojsh. Bucela u mbush. Sufa e rroku atë dhe e ngriti me dy duert, kurse Mrika ktheu shpinën që të ujdisë bucelën e randë plot ujë.

-Po si të kishte thanë gjyshja ?... -vazhdoi Sufa teksa po i mbante bucelën.

-Ti e di vetë, or Sufë... U duhet djemve që u teket për ndoj cucë në katund, se me tërfojën thonë se i rrejnë e fitojnë jaranen! Mrika kishte kthye duert prapa e priste që Sufa t'i zgjatëte tërkuzën, po ia po bante naze, tue u rrekë sikur ishte ngatrrue tërkuza. Ai po mendonte se si Mrikën, bashkë me bucelën, t'i përlante në krah e të fluturonte. Iu duk vehtja si dif!

-Më duhet nji fletë ksisoji, Mrikë domosdo më duhet ndihmë ta gjejmë, në ke zemër!

-Kujt do të ja japësh? Thuej të drejtën e Zotit e mos e fsheh, se do Zoti e të ndihi edhe pa tërfojë. Sufa i kapi dorën e nisi të ja shtrëngonte e të ja fërkonte si i dehun. Po, ai ishte dehun nga nji raki e fortë që e ndez shpirtin si prush!

-Ty Mrikë, ... Mrikë, ty po të thom, ty due me ta dhanë e askujt tjetër! Nuk flej, për ty, . . Mrikë!... Po më shtie të gjallë në dhe. Besomë, shpirtin ta kam ba kurban, ty, Mrikë! Besomë, Mrikë!... Mrika u turbullue edhe ma keq, po ma në fund e lidhi bucelën vetë dhe skucun flakë në fytyrë u kthye të niset për në shtëpi, por Sufa, që ishte nxe, sikur kishte marrë zjarrm, lëshoi duert mbi gjinjët e saj, që ishin nda nga terkuza e kishin dalë ma fort në pah, në të dy anët e gjoksit të Mrikës dhe dora e djathtë, si pa dashtë u shtrëngue ma shumë. Sufa kujtoi se kishte në dorë bash nji pamel zhuri. Kurse vajza thërriti oh! Dhe i luteshe me nji za të dridhshëm:

- Sufë, Sufë largo duert, mos ma cek nderin!...

- Fol, Mrikë, Mrikë, rrimë nji çikë ndër degë të shelgut? Mrikë të due fort!... Askush nuk na shef, veç valëve të Drinit e ato ikin e nuk folin gja. Beso , në ke zemër, Mrikë!... Vajza nuk bante za. Tamthat po i rrifshin fort e zemra gati sapo plaste kraharorin. Edhe ajo u turbullue si kurrë njiherë, Zemra po e tradhëtonte. "O Zot, si u turbullova kështu... " mendonte Mrika me vehte, kur me gjithë bucelën në shpinë ishte në krahët e Sufës, i cili e kishte pushtue e duert s'i shqitëte prej gjoksit, si të kishte zanë nji shqiponjë!...

* * *

Dedë Gjakola ishte i gëzuem pa masë, se për fat të mirë, atë natë që do të vrasë bletën i erdhi nji mik i mirë:Mark Jovani. Ai i kërkoi vajzën, Mrikën, për mikun e vet, që siç thoshte Marku, kishte treqind kokë dhi e dhen, e konaku i tij ishte për treqind pushkë. Tepsijat ishin mbushun me hoje. Miku kishte kapun nji copë të verdhë, e mjalti i kullonte duerve. Ai lëpinte duert e gishtat dhe sytë nuk ia ndante Mrikës, e cila rrinte kokëulun e tue ndihmue të jatin. Edhe ajo e kishte mendjen tek Sufa.

-Ambël si kjo mjaltë na vaftë miqësia, or Dedë!- tha Marku.

-Të baftë mirë, e mirë se të ka pru Zoti në shtëpinë tonë! – ia priti Deda .

-Miq si ty pritshim gjithmonë, or Mark!

Të nesërmen u hap fjala në katund se Mrika e Dedë Gjokolës na qenka fejue me nji zengjin, përtej Drinit. Por burri na qenka siç thoshin disa që e njifshin gjysmë budallë e me një moshë mbi dyzet vjeç. Lajmi e theri në zemër Sufën e shpresat iu prenë. Mbas tre katër ditësh edhe Stafë Bitri i zuni nuse të vëllait Sufës. Nuse për kryet e nuses. Thonë se ishte flokë verdhë si cucë Mërskovi. Vajzat e përtej Drinit janë të hijshme e të shëndosha, por kjo nuk e gëzoi fare Sufën. Edhe katundarët nisen me thanë, se Mrikën e Dedë Gjokolës e Sufë Bitrin i ka marrë fejesa për keq, po ligen çdo ditë e po bahen për ibret sikur pinë uthull e jo mjaltë e qumësht, që u ka falë Zoti boll. Zakonisht, në këto anë dasmat bahen "Shëmrijes", që bije aty nga 15 gushti, me kalendarin e vjetër. Në katund do të baheshin shumë dasma. Do dilte nuse Mrika. Edhe Sufë Bitri do të merrte nuse nga përtej Drinit. Mrika e Dedës e Sufë Bitri ishin takue shpesh, por askujt nuk i kishte vojt mendja për të keq e sidomos tash që i fejuen dhe që sipas kanunit, çdo gja kishte marrë fund. "Ato janë si një familje", - thoshin katundarët por At Përgjoni, prifti i katundit, sikur i kishte pa një ditë të dy së bashku prapa kishës e bile i kishte pa keq, tuj u puthë e përqafue por asgja nuk tha. Nji ditë ai e kishte ftue Mrikën që të rrëfehesh. Vajza e zanë ngushtë në prangun e martesës, shkoi në ▸

skica

"Gjeografia e tyre është kjo, në rrugët e Tiranës, Peshkopisë, Shupenzë, Maqellarës. Bulqizes etj. Kështu duhet të edukohet shqipëtari kokëfort. Me dhunën e policit të shtrirë. E ky është edukim i veçant, origjinal, pa kushte lehtësuese e modernizime. "

kishë dhe u rrëfye, fije për pe, përpara At Pergjonit.

-Zoti qoftë me ty, moj Mrikë, harroje Sufën!- i tha prifti.

-Aman, At, aman!... - luteshe ajo e gjunjëzueme para priftit. O Sufën, o do të mbytem në Dri! e due atë si vehten teme! Ai ma ka marrë zemrën! Çdo gja ja kam dhanë atij, o At i shenjtë! Prifti i kishte lëshue sytë si me inat Mrikës e mandej i kishte folë:

-E ke në besë Sufën? Mos të ka gabue e mandej të le në rrugë!...

-Si ty, o At e kam në besë, si perëndinë! Ai po vdes për mue, më don fort. E kam provue dashuninë e tij të dlirtë.

-Shko, pra dhe nesër eni me Sufën këtu. Do t'ju ndihmoj sa të mundem... do t'ju bekoj! Mrika u ul, i puthi kambët priftit, por ai e ngriti...

-Shko, shko!. .

At Pergjoni, vetëm ka emnin prift, por e duen të dy kastet. Edhe muhamedanët e dëgjojnë dhe e respektojnë. Sa familje ka pajtue ai midis tyne. Sa i mirë asht, edhe pse nuk e ka mirë me ata kryetarët e fesë së qytetit, prapë së prapë e duen shumë.

... Dielli ishte ngritë e gjinkallat të çjerrshin veshët. Sufa, si kceu gardhin nga prapa kishës, hyni në bahçen e saj të mbushun plot me pemë. Zemra i rrihtë fort dhe ishte mjaft i trembun: "Ç'po baj kështu, po sikur të më shofin nana me vëllanë?" Por në atë çast u ndie nji za:

-Hajde bir, hajde, pse vjen si hajdut? -Ishte At Pergjoni e u përkul para atij në shej nderimi.

- Hajde mbrenda...

Sufa e Mrika qëndrojshin krah njeni-tjetrit, e At Pergjoni, që ishte përballë, i bekonte ata me fjalët e tij të zakonshme. Kur ceremonia e thjeshtë kishte mbarue. At Pergjoni zbriti shkallët, u afrue e si i puthi në ballë, u tha:

-Perëndia qoftë me ju, Zoti u faltë dashuninë. Rruga asht e randë, por dashunia, as ngrin e as digjet. Ajo rron e ndriçon të dy botët. Lum ai që jeton me të në zemër. Tani do të merrni udhën e pyllit. Atje asht nji shenjtore, ku shërben nji katundar i mirë. Ai do të ju bashkojë me njerëz të sigurtë. I thoni se na dërgoi At Pergjoni, i thoni se na bekue At Pergjoni. Rruga e mbarë, bijtë e mi.

Dy të rinjtë u panë sy në sy. Mrikës i rodhën lot, kurse Sufa i tha asaj ngadalë:

- Unë e kërkova me ditë të tana, nëpër fushat e livadhe një tërfojë me katër fletë, por ja se këtë e paske pas në gji ti, o Mrikë e dashtun. Mandej ata të dy, me zemrat e bashkueme, muerrën arratinë. . Nuk kishin armë në dorë, po kishin nji armë të fortë si rrufeja, dashuninë e dlirtë, që s'njef fe e ligje, që se lidh me hekura, që s'e varros kurrë në dhe... U ngrit në kambë gjithë katundi, tue kërkue ata që tradhëtuen fe e zakon. Te kisha u grumbulluen të gjithë. "Tregona, - thanë Deda me Stafën, ç'të bajmë? Ku ti gjejmë? Se kjo s'ka ndodhë deri më sot. Na kena mbetë me vu në krye shami të zeza, për turpin që na ra në dyer".

- Jepni dorën njëni- tjetrit, e mos mbani mëni, dashunia nuk njeh fe e ligje... Ajo asht vetë Perëndia, fytyra e tij.

-Do t'i djegim së gjalli, po i zumë!- thanë ata nji zani, Edhe në qiell të venë do ti zamë. . Katundarët nuk banë za. Ata s'e kuptojshin ç'po ndodh, e si do të vejë kjo punë. Ky ishte fillimi, fillimi i nji kanuni të ri njerëzor...

Skica nga Selman Meziu

ZGJUARSIA

Ishin orët, ditët e mujit te vitit nëntëdhjetë. Shumë të ngarkuara me ngjarje, intime familiare, shoqërore, politike dhe ekonomike. Kudo që ndodheshin njerëzit, në Lurë, Sllovë, Ternovë dëshironin hapsira të reja jete. Kerkohesh, zgjuarsi, lëvizje të matura, taktikisht të pranueshme për momentin. Sulmi i bafasishëm, tërheqia e përkohëshme e përsëri me guxim në sulm.

Njëri nga të katër vëllezërit, me ato pak lekë që kishte, zbret në Fushë Kamez. Duke kërkuar gjen dy degë, me nje thikë, bën katër piketa. Mat me hapa dhe i ngul këto me mundim ne token e fortë, duke llogaritur katër dynim tokë. Kthehet në Lurë, dhe iu rrëfen, vëllezërve per aventurën. Kerciti muhabeti e mendimet e kundërta. Pas asaj nate, gjithëçka u harrua.

Por në brendësi te shpirtit djaloshar, diçka e gërryente e shtynte, të kërkoi rezultatin. Ne ditën e nëntëdhjetë e dytë, rikthehet. Në afërsi të tijë piketa të tjera, diku më larg, grumbuj gurësh. Një djalosh me një karrocë me gomar, po transportonte gur. Ky e porositi për dy të tilla duke ditur edhe sa lekë kishte ne portofolin e tijë. Vendos këto në dy vende. Kthehet në shtëpi i gëzuar edhe pse rruga ishte e gjatë dhe e lodhshme. Nga radio, televizoni, gazetat, dëgjohej e shkruhej për ndryshime të mëdha.

Koha kalonte me të shpejtë duke u marrë me punëra të ndryshme. Një ditë të bukur vjeshte, ai merr djalin e madh e rikthehet në vendin e shënuar. Përball tijë peisazhi kishte pësuar mdryshime. Shiheshin aty këtu kasolle me kashtë, baraka prej dërrase, çadra te mëdha si ato te gjeologeve. E aty këtu kasolle me blloqe betoni.

Pasi foli me vellezerit per situatën e prones se re. Ne pjesen e tije me ato pak lekë që kishte, ai ndërton një shtëpij të thjeshtë. Më pas dikush me shitje të asajë pak toke dikush me financim nga kurbeti, ngrihen katër shtëpi. Komshijtë tashmë ishin të rinj, nga Arni i Kukësit, nga Stebleva, nga Burgajet i Matit. E keshtu dalë nga dalë Fushë Kamëza e Tiranës kthehet në një lagje të sajë.

LIDHJA E BESËS

Të jesh emigrant. Të integrohesh. Të punosh në çfarëdolloje pune. Të ndërtosh të ardhmen. Të respektosh ligjet e rregullat. Të bësh krime e të përfundosh në burg. Apo të shkërmoqesh shpirtin e zemrën tënde, për pasigurin që të ndjek si hije e zezë. Nuk e di! Flet radio, gumzhinë televizioni shkruajnë gazetat. Trullosem, djersitem nga ky presion psikologjok. Racizem. Nuk besoi që në shekullin e njëzet e njëte të ketë qeliza truri që të shprehin këtë.

Atëhere kur lajthisin anëtaret e partisë, Lidhja e vermut? Krytari i sajë Umberto Bosi, si reagon? Karte Qendrimi me pikë, si patentat e shoferave. Sa herë këto të fundit shkelin kodin rrugor, hiqet një sasi pikësh. E kur ato mbarojn, i hiqet patenta për nje periudhe kohe. ç'fantazi e kulluar racizmi!

Për emigrantin kështu duhet të funksoinoj. Kur shkel ligjet e rregullat ai ndëshkohet. E kur i mbarojnë pikët ? Duhet të mbledh leckat e të shkojë në mëmëdheun e tijë. Po si kështu? Po ai që ka fëmijet në shkollë, kopsht e çerdhe, e gruan në punë? Të gjithë i rruan një brisk, ai i partisë së filozofëve të Bosit. Ato duan të ndajnë Italinë në veri jugë e jo ma familjet e emigrantëve. Po kështu duhet të ndodh edhe me fëmijet e tyre ne shkolla. Klasa të veçanta. Ç'farë xhevahirësh racizmi!

Nuk mjaftohen me kaq por këto punonjës të punëve më të rënda, duhet të paguajn për çdo Leje Qëndrimi, dyqind euro në vit., E kush ia qane hallin atije qe ka shumë fëmijë të vegjël e gruan pa punë? Siç shihet nga sllloganet ata të Partisë së alpeve kanë kokën shkëmb, e trurin fyll.

E këto euro duan tia shpërndajn trembëdhjet milonëve italian që jetojn nën nivelin mesatar te popullsis. Ç'farë ideshë gjeniale!

E ata trumbetojne se me të tilla reprezalje kundër emgrantëve do të shpëtojne edhe vëllezerit e tyre që punojnë në minierat e Gjermanisë, Belgjikës, në Sh . B. A e Australi, Francë etj. Në programin e tyre partiake do të pasurojnë popullin e veriut e të shkatërrojne jetën e qindra mijëra emigranteve. Për këtë ato kanë lidhë besën. E at ia kanë dhënë nënës parti.

POLICI I SHTRIRË

Pallate, ndërtime private të vendosura sipas rastësise. Pa menduar për kalim makinash, ndërrimin e tyre. As për kanalizimet e tubacionet, për ndërlidhje, korent etjer. Një rrëmujë e vërtet, babiloni hesapi.

Shumë keq këto. Sigurish që do të duan dhjetë vjeçar të tërë për tu sistemuar. Por për makinat që kalojnë me shpejtësi? Si t'a ulim sasinë e pluhurit që ndot mjedisin? E aksidentet e shumta që ndodhin?

Njeriu ka vënë mendjen në lëvizje. Për të lehtësuar punën. Për të mbrojtur vetëveten apo luftuar të tjerët. Ndërsa inxhinirët e projektimit të rrugëve e policia e sajë kanë dhënë ide xheniale

Për së gjëri një shirit betoni. Që shoferi kur ta shohe të ul shpejtësinë ose.... .

Një rrjesht tullash, të gjithëfarë formash apo madhësie e përbërje. Litarë të trashë që përdoren për ankorim anijesh por sigurisht të gozhduar . ç'far larmie policësh të shtrirë. Kursejmë ato të gjallë, njëkohesisht shkatërrojme makinat me goma e amortizator. Pasurojmë fjalorin e të sharave e mallkimeve.

Gjeografia e tyre është kjo, në rrugët e Tiranës, Peshkopisë, Shupenzë, Maqellarës. Bulqizes etj. Kështu duhet të edukohet shqipëtari kokëfort. Me dhunën e policit të shtrirë. E ky është edukim i veçant, origjinal, pa kushte lehtësuese e modernizime.

FLAMURI E ARAPI I ZI

Një dru, apo një rrjesht drurësh në rrugët e qytetit apo të një vile. Ç'far mund të tregojnë? Filtrues papastërtish të ajrit. Bukuri që të mahnit e të gjallëron. Hije aq shumë e domozdoshme në vapën përvëluese të Gushtit. Shoqërues besnik e orintues për të parë e ecur i qetë pa strese, në këmbë ose me makinë.

Rrugët kryesore të Tiranës janë zgjeruar. Në buzë tortuareve drurë të rinj të llojeve të ndryshme. Edhe pse gjatësine më të madhe të tyre e mbulon Rrapi. shtë rraca jonë që gjendet kryesisht brigjeve të lumenjëve ujëshumtë e shtratë gjërë të

Matit, Shkumbinit, Vjoses Semanit etj. Por inxhinierët e lulishtarisë kërkojnë t'iu bëjnë pashaportizimin në Tiranë bijëve të tyre pse jo edhe rinisë. . Deri këtu nuk ka asgjë të keqe se edhe banorët e sajë janë përzier nga Tropoja, Dibra, Skrapari, Leskoviku etj. Por a e meritojnë?

Pas moshës njëzetë vjeçare këto bashibuzuk lumenjsh, ndërrojn ngjyrën e lëvoreslëvoria e cila bëhet e përhimtë . Më pas mbinë myshku i cili për shumë muaji mban ngjyrën e zezë. Kështu që nuk të ngjallë asnjë pikë kënaqësie. Për këtë shikoni me kujdes ato që janë pashaportizuar që prej dyzeet vjetësh. E do të thoni: Juve keni të drejtë. Ato shëndrohen në nje arap të zi që as te emocionon as të orienton, edhe në dritën e neoneve.

Zgjidhja është e thjeshë Kush ka shëtitur rrugët e Vjenës, të Parisit, Brukselit, Firences, Milanos etj, etj i kujtohet lëvoria e bardhë e Rrapit fletë panjë, me kurorë të krasitur vazhdimisht. Nuk është vështirë ta gjesh, por kushton, se është mall importi. E për rrjedhojë në Stemën e flamurit të Tiranës do të jetë së shpejti një arap i zi me gjethen e rrapit të stopanit me doren te ngritur lart. Pa dyshim ne nuk kopjojm flamurin kanadez qe ka vetem nje gjethe rrapi.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Shkruaj dhe ti mendimin tënd!

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

duke u pajtuar dhe duke bashkëpunuar

gazeta hap faqet e saj për të rinjtë e shkollave, kryesisht për ata që pretendojnë të fillojnë rrugën e gazetarisë, duke krijuar hapsira të posaçme për krijimet e tyreletrare e publicistike...

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.

Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

www.dibra.org

“Misteret e trafikut të armëve në Shqipëri”, një libër-apel për zbardhjen e të vërtetave të dhimbshme



Nga:
ARTAN HOXHA
Gazetar



Publikimi për daljen nga shtypi i librit “Misteret e trafikut të armëve në Shqipëri” nga gazeta “Rruga e Arbërit”, përveçse një vlerësim për këtë botim serioz e me vlerë lidhur me një fenomen të shumëpërfolur e pak të njohur nga publiku shqiptar, atë të fatit të arsenalit luftarak vdekjeprurës shqiptar ndër dekada, ka dhe një obligim të veçantë: dy nga bashkëautorët e këtij libri, gazetari Kujtim Boriçi dhe inxhinieri e pedagogu ushtarak Eduart Abazi, janë nga Dibra. Këta të dy, së bashku me ushtarakun e njohur, Kolonel Zyhdi Krojin, zgjodhën me kënaqësi që këtë libër ta promovojnë së pari në gazetën tonë, ku janë njëkohësisht dhe bashkëpunëtorë e lexues të rregullt të saj.

Më datë 10 mars, pesë ditë para një vjetorit të tragjedisë së Gërdecit, autorët do promovojnë librin në Qendrën Kulturore të Ushtrisë (SHQUP), Tiranë. Me këtë rast, redaksia, duke falënderuar autorët për kontributin e tyre në dokumentimin e kësaj tragjedie për opinionin publik, ju uron edhe suksese të mëtejshme!

REDAKSIA

“Misteret e trafikut të armëve në Shqipëri” është një libër i veçantë nga botimet e deritanishme që lidhen direkt apo indirekt me ushtrinë. Së pari, për mënyrën e konceptimit të një problemi sa të mprehtë, aq edhe të shumëpërfolur në vend, në arenën ndërkombëtare si dhe objekt hetimi i Drejtësisë shqiptare e asaj ndërkombëtare. Së dyti, mënyra krejt origjinale e të shkruarit, të paraqitjes së dokumentit, të faktit apo të dëshmisë. E që të dyja këto veçori, me një përgjegjësi të plotë kombëtare, profesionale dhe etike njëkohësisht. Pra, larg komentit, vlerësimeve, gjykimeve apo paragjykimeve që hasen nëpër libra të kësaj natyre, autorët, nga faqja në faqe, nga rreshti i parë deri tek i fundit na thonë: “I dashur lexues! Ja cilat janë faktet, dokumentet, vlerësimet zyrtare e publike rreth mistereve të shitjes, trafikimit e demontimit të armëve e municioneve shqiptare. Ja ç´kanë thënë të tjerët, ja çfarë kanë thënë vet ata që janë implikuar apo i implikojnë në këtë fushë. Nuk kanë rëndësi emrat, por fenomeni. Lexo, e nxirr konkluzionet vetë!” Mënyra e ndërtimit të librit, kompozicionit, renditjes së dokumenteve, dëshmive, në një farë mënyre e ndihmojnë lexuesin të kuptojë sa më qartë se çfarë ka ndodhur. Mendojmë se ky libër është produkti i nivelit të ushtarakut akademik me eksperiencë e njohje shumë të mirë të problemeve që trajton libri dhe problemeve të ushtrisë, i pjekurisë, formimit intelektual të pedagogut ushtarak, që di të racionalizojë e të përzgjedhë fjalën në kohën e vendin e duhur, si dhe i gazetarit profesionist që intelekti, shkalla e njohjes së problemeve dhe eksperienca e ndihmojnë në gjetjen e gjuhës më të efektshme me lexuesin. Ndërthurja dhe shkrirja në një të vetme e prirjeve apo specifikave të çdo njërit prej autorëve, i jep librit një origjinalitet të spikatur. U ndala këtu, jo thjesht për të vlerësuar autorët, megjithëse kjo është një gjë plotësisht e motivuar, por për të thënë se këtë libër, ia vlen ta lexosh, e jo vetëm kaq.

Ky botim nuk është vetëm një almanak i arsenalit luftarak të Ushtrisë Shqiptare, i cili i shtohet thesarit të bibliotekave tuaja private, por dhe një pikë referimi për çdo autor dhe studiues që do të hulumtojë në të ardhmen në këtë fushë.

Të kthehemi shkurtimisht tek libri. Një ndër të veçantat është se në të ka dokumente e shifra të shumta, që për një lexues sipërfaqësor, ndoshta, në dukje ngjajnë të lodhshme. Por, prapa çdo dokumenti e çdo shifre, “lexohet” shumë. Dihet që për dekada, së paku nga Lufta e Dytë Botërore e deri në vitin 1990, për politikën shtetërore të kohës, konjukturat ndërkombëtare e faktorë të tjerë, ushtria shqiptare ishte e madhe në numër dhe e superarmatosur me teknikën luftarake bashkëkohore. Shumë shpejt, siç del dhe në libër, nga arsenali i luftës partizane, ushtria do të kompletohej me armë e municione sipas planifikimit për përballimin e një lufte shumë të gjatë. Armët luftarake silleshin nga vendet aleate, të cilët ishin ndër fuqitë më të mëdha të kohës, me të cilët u lidh Shqipëria. Fillimisht me Bashkimin Sovjetik, e më pas me Republikën Popullore të Kinës. Sigurisht, për efekt të sekretit ushtarak dhe shtetëror që përbënin organikat e reparteve ushtarake (aktive e në rezervë) dhe teknika luftarake, asnjëherë nuk u mësua plotësisht sasia e armëve dhe municioneve luftarake në vend. Ndërsa më vonë, kur Shqipëria mbeti e izoluar, me parimin: “Mbrojtja me forcat tona”, u ndërpre ardhja e armatimit e municioneve nga jashtë. Kështu që nisi instalimi në vend i uzinave ushtarake, fillimisht për prodhimin e armëve (të lehta) e municioneve, si në Gramsh, Poliçan e Mjekës të Elbasanit. Po, sa armë u prodhuan; A u shitën e dhuruan këto armë jashtë Shqipërisë nga shteti i kohës, kjo mbeti enigmë. Diku në libër jepen shifra e detaje dhe për këtë fakt, që po të analizohen me pak kujdes nga lexuesi, mësohen detaje të një mekanizmi perfekt, por tepër të sofistikuar e sekret që vazhdoi jo pak, por me vite e dekada.

Klasa politike që pasoi ndryshimin e sistemit në vitin 1990, fatkeqësisht e pa ushtrinë, brezat e ushtarakëve, si një “mëkat” të kohës që shkoi, ndërsa arsenalin luftarak, si mjet për të abuzuar e përfituar me to. Fillimisht, një dekret i ish-Presidentit të Republikës, Ramiz Alia i hapi rrugën shitjes legale të armëve jashtë vendit. Pikërisht këtu, siç dëshmohet dhe në libër, nëpërmjet dokumenteve autentike, nis dhe përpjekja mafioze e personave me pushtet apo grupeve të caktuara për të përfituar nga armët dhe municionet luftarake. Edhe pse nga viti në vit pati akuza për abuzime, shitje, falje e trafikim të armëve e municioneve, destinacioni i arsenalit luftarak mbeti mister. Ndërsa, tragjedia e Gërdecit bëri që të dalin në shesh shumë detaje konkrete të abuzimeve, deri në nisjen e hetimeve nga agjencitë ligjzbatuese në vend. Me shumë kujdes, dokumentet e dëshmitë e sjella në libër, japin mjaft hollësi në këtë drejtim.

Së fundi, ky libër, ndonëse është libër publicistik, ku autorët “flasin” me dokumente e dëshmi, ka vlera të veçanta, pasi tenton zbardhjen e mjaft nga fakteve të përfolura rreth arsenalit luftarak shqiptar të gjysmën së dytë të shekullit të kaluar. Pra, është i pari që hap një sipar drejt shumë të panjohurave, që nesër mund të pasurohen më tej nga autorë e studiues të tjerë.

Mendoj që ky libër duhet lexuar sa më shpejt e duhet të jetë në bibliotekën e lexuesit të çdo moshe e profesioni.

FLET EDUART ABAZI:

Një dëshmi për tragjedinë

Libri juaj është një libër i veçantë dhe i pari që botohet për një nga problemet më të mprehta e më të përfolura kohët e fundit, veçanërisht pas tragjedisë së Gërdecit, atë të fatit të shitjes e trafikimit të armëve e municioneve shqiptare?



Ndoshta nuk është plotësisht e saktë kështu. Kjo pasi për problemin e shitjes apo trafikimit të arsenalit ushtarak, në kohën e regjimit komunist e veçanërisht pas ndërrimit të sistemeve politike më 1990, është folur e shkruar jo pak. Janë botuar të dhëna zyrtare, shkresa e dokumenta të ndryshme. Sigurisht, dhe ne si autorë të librit, si intelektualë, për hirë të funksioneve e detyrave që kemi kryer apo bëjmë, por dhe thjeshtë si qytetarë të këtij vendi, kemi patur interes dhe për këtë problem, ashtu si dhe për shumë probleme të tjera. Por jo se kemi punuar enkas gjatë për të bërë një libër. Por ishte tragjedia e Gërdecit, dhimbja për ato jetë të pafajëshme që në fund të fundit e gjetën vdekjen nga municionet luftarake që na nxiti të punojmë me objekt, të shkruajmë këtë libër. Kështu, njohjeve që kishim, dokumentave, arkivave të kohës që I kishim në arkivat personale, me përgjegjësi e profesionalizëm, tu shtonim të tjera..

Më konkretisht në këtë drejtim?

Po. Po të shikoni nga faqa e parë deri në faqen e fundit të librit, ne sjellim vetëm dokumentin, materialin e marrë në arkivën e shtetit, në ato të ministrive e institucione trë tjera. Në asnjë rast ne nuk bëjmë komentin e faktit apo dëshmisë, të ngjarjeës apo pohimit. Nuk marrim përsipër të sjellim shkaktarë apo përgjegjësinë. Kjo u takon të tjerëve. Qëllimi është që të sjellim një sërë dokumentash rë njohura e të panjohura, të publikuara apo jo. Kemi sjellë urdhëra, vendime, statistikave zyrtare që lidhen me problemin e trajtuar, dokumente të cilësuara dikur secrete apo tepër secrete, deklarata të qeveritarëve, funksionarëve vendas e të huaj, publikime të medias vendase e të huaj për fatin e armëve e municioneve shqiptare. Por pa marr përsipër të gjykojmë autorët apo atë që thonë apo shkruajnë. Synimi është të afronim lexuesit diçka serioze në funksion të hedhjes dritë mbi këtë problem të mprehtë, mistereve që e kanë veshur apo e mbajnë të trillë dhe tani.

Dy gjëra vihen re në këtë libër, dokumentat origjinale (dëshmitë) por dhe një mature e kujdes për të mos lëvizur aspak nga konteksi i tyre. Së pari burimi I dokumentave që keni përdorur dhe mundësia e sigurimit të tyre?

Po. Për gazetarin preofesionist që ka aftësinë, pjekurinë por dhe aksesin për të gërmuar në arkiva dhe eksperienca për përdorimin racionalt të materiualit, për ushtarakun e karrierës që ndër dekada njeh në detaje ushtrinë, jetën e saj e arsenalin luftarak si dhe intelektualin që ka jetuar e jeton me kohën, nëse është dëshira për një gjë të mirë në dobi të shoqërisë e kombit, arrihet. Ndërsa për atë që ju thoni “kujdes e matur”, kjo lidhet jo vetëm me qëllimin tonë si autorë për tu dhënë lexuesve e të interesuarve një gjë me vlerë, por dhe me përgjegjësinë për atë që sjellim. Përgjegjësinë ndaj lexuesit, qytetarëve, ndaj vetes dhe interesave të shoqërisë e të kombit. E theksoj se ne sjellim në mënyrë të konçize e pa bërë koment atë që gjykojmë se hedh dritë në aferat lidhur me shitjen apo trafikimin e armëve e municioneve luftarake që janë e mbeten pasuri e gjithë qytetarëve. Ndodhi një tragjedi, ajo e Gërdecit. Po rrezikohen dhe të tjera. Shteti ka instrumentat të vendosë pikat mbi “i”. Detyra e intelektualit, qytetarit është të apelojë, të bëj aq sa mundet. U takon atyre (organeve përgjegjëse) të bëjnë detyrën…

Libri juaj del nga botimi 1 vit pas tragjedisë së Gërdecit. Mos ishte ky shkaku që zgjodhët këtë kohë?

Përfundimi i librit përkon me këtë datë të dhimbëshme që vështirë të harrohet. Së paku, pa u njohur përgjegjësit e kësaj masakre që çoi në 26 viktima të pafajëshme.

Këto dit, pikërisht më 10 mars, pesë ditë para se të mbushet një vit nga kjo tragjedi, do të bëhet promovimi i këtij libri. Le të jetë libri vetë dhe aktiviteti një homazh për viktimat e pafajshme të kësaj tzragjedie. Por dhe një apel që e drejta dhe e vërtea të zbardhet sa më parë.

Faleminderit!